



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Janar 2022/ Nr. 1



VJET REVISTA "MBROJTJA"



Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj:
Shtypi Ushtarak, ura e komunikimit për të njohur modelet më të mira të sjelljes



Drejtoresha e QKMBMMFA Mirela Roshi:
Mirënjohje të thellë për kontributin tuaj me profesionalizëm dhe përkushtimin, në ngritjen profesionale dhe cilësore të revistës "Mbrojtja"



Musollari: 90-vjetori i krijimit të revistës "Mbrojtja", histori frymëzimi për brezat e rinj

Përmbajtja

Numri 1

Misioni

- 12** Shtypi ushtarak në rrugëtimin e tij historik

SHTYPI USHTARAK NDËR VITE

- 22** Fotografia, arti i përjetësimit të figurave që historia lë pas

VIZITA

- 34** Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Defender Europe-21 ishte shembulli më i mirë i këtij bashkëpunimi

PËRFTITIMET E PLATFORMËS DIXHITALE

- 35** "E-Albania", portali që iu shërben të gjithëve, civilë dhe ushtarakë

GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU:

- 36** "Profesionalizmi dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD profesionale dhe specialitet "niche"

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 GJENERALMAJOR BEGAJ

Shtypi Ushtarak, ura e komunikimit për të njohur modelet më të mira të sjelljes

Të nderuar gazetarë dhe bashkëpunëtorë të shtypit ushtarak ndër vite, të revistës "Mbrojtja" dhe gazetës "Ushtria", është kënaqësi e madhe për mua të uroj në këtë...



28 VITI I RI

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: I lumtur që jam sot mes jush, e ardhmja jonë!

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u organizuan nga sektori i aktiviteteve, pranë QKMBMFA, festimet e vitit të ri me fëmijët e prindërve...



30 NIS REKRUTIMI PËR USHTARË/DETARË

Sot i shikojmë në sy të gjithë të rinjtë dhe të rejtat të cilëve iu drejtojmë ftesën për t'u bërë pjesë e FA-së

Nga Elbasani nisi procesi i rekrutimit për ushtarë/detarë në Forcat e Armatosura. Pjesë e aktivitetit ishin ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm...



32 RREZIKU NGA SULMET KIBERNETIKE

Peleshi: Qeveria do të subvencionojë studimet në këtë fushë, bonuse për specialistët e mbrojtjes kibernetike në shtet
Siguria kibernetike po bëhet çdo ditë e më shumë një fushë që kërkon fuqi punëtore të specializuar, ndaj ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, si drejtues...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 1/ 2022

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>





Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Shtypi Ushtarak, ura e komunikimit për të njohur modelet më të mira të sjelljes

Fjala Përshëndetëse e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, në përvjetorin e 90-të të krijimit të Revistës Mbrojtja

Të nderuar gazetarë dhe bashkëpunëtorë të shtypit ushtarak ndër vite, të revistës "Mbrotjtja" dhe gazetës "Ushtria", është kënaqësi e madhe për mua të uroj në këtë 90-vjetor të krijimit, të një prej organeve më të hershme të shtypit shqiptar, revistës "Mbrotjtja", organ i rëndësishëm i Shtypit Ushtarak, në faqet e të cilës udhëton historia 90-vjeçare e ushtarakut të Forcave të Armatosura.

Liria e shprehjes dhe e informacionit është një nga themelet e një shoqërie të shëndetshme demokratike si dhe e rritjes sociale dhe ekonomike. Rrjedhja e lirë e ideve dhe informacionit është e domosdoshme për inovacionin dhe mbështet parimet e përgjegjësisë dhe transparencës brenda një shoqërie. Hapësira demokratike për mbrotjtësit e të drejtave të njeriut, opinionistëve dhe gazetarëve sa vjen e po merr përmasa të mëdha.

Trendi i zhvillimeve teknologjike në rang global në industrinë e medias ka ndikuar edhe funksionimin dhe zhvillimin e medias shqiptare, si nga aspekti teknik dhe infrastrukturor, po ashtu edhe në cilësinë dhe kushtet e burimeve njerëzore të angazhuara në këtë fushë. Por e sotmja jonë nuk do ishte kaq e ndritur pa të shkuarën historike, suksesi i së cilës, edhe pse jo në kushtet e sotme, por me një laps, një copë letër dhe me një mendje të ndritur, solli në jetë shtypin ushtarak, bazat e të cilit i hodhën pikërisht ata njerëz që pak kohë më parë kishin luftuar me armë në dorë për mbrotjtjen e atdheut dhe më pas për përhapjen e dijes mes këtij shtypi. Mirënjohje pa fund për të gjithë këta burra të mençur që ndërtuan nga asgjëja atë që sot brezat e rinj po e shpjen në standardin e simotrave të saj Europiane.

Revista "Mbrotjtja" mbushi 90 vjet! Gjatë gjithë kësaj periudhe ajo ka pasqyruar veprimtarinë dhe aktivitetin e Forcave të Armatosura, krijimin, transformimin, ristrukturimin dhe modernizimin e saj, me të gjitha problematikat dhe sukseset, me të gjitha vështirësitë dhe sakrificat.

Ju jemi falënderues për pasqyrimin me profesionalizëm të lartë të aktiviteteve të Forcave të Armatosura, si një histori e shkruar për brezat që vijnë pas.

Falënderoj në mënyrë të veçantë të gjithë ata që në këto 90 vjet kanë dhënë kontribut në këtë fushë. Ato zonja dhe zotërinj pjesë elitë e brezave ndër vite të gazetarisë dhe bashkëpunëtorë të shtypit ushtarak, dëshmia e gjallë e jetëgjatësisë të shtypit ushtarak në dekada. Kontributi i tyre është i lidhur drejtpërdrejtë me thelbin e ushtrisë.

Shtypi Ushtarak, ka një detyrë të madhe, ka detyrën e komunikimit dhe të bërit të njohur të

ekzistencën dhe për të realizuar funksionin e saj. Në anën tjetër janë individët, komunitetet dhe organizmat e krijuara prej tyre, që kërkojnë të marrin dhe të japin informacion. Publiciteti, bashkëpunimi aktiv, bindja, këshillimi dhe manipulimi si faktorë përcaktues të efektit të informimit janë në rendin e ditës. Burimet, informacionet dhe vetë individët thithës/përcjellës janë të pafund.

Lexuesi ushtarak i kohës së sotme është gjithashtu një lexues jo vetëm i kultivuar tashmë, por më së tepërmi një lexues dixhital, që informohet në të gjitha format e mundshme, elektronike apo tradicionale. Por ne kemi sta-



modeleve më të mira të sjelljes, të përkushtimit dhe të sakrificës së ushtarakut tonë të FA, ai vjen më i konsoliduar se kurrë, me orientim të qartë euroatlantik, me profil perëndimor, zëri dhe imazhi i një Force të Armatosur solide operacionale, misionare në veprim, zëri i Forcave të Armatosura Shqiptare, që kanë shkruar histori suksesi si partnere të denja në NATO.

Në shoqëritë moderne, ku revolucioni informatik po arrin shkallën më të lartë të zhvillimit, ku pretendohet dhe shpresohet për një shoqëri sa më të hapur, me kufij shtetërore gjithnjë e më shumë relative, ku flitet për autostrada informacioni, është krijuar një infrastrukturë gjigante që kërkon lëndë të parë për të justifikuar

fin dhe drejtuesit gjithashtu, që nga ana tjetër, kanë një përvojë të çmuar përpara, 90-vjeçare, dhe me profesionalizëm dinë të ndërtojnë punën e tyre. Duke uruar për këtë 90-vjetor të krijimit të revistës së parë ushtarake dhe për rrjedhojë të revistës "Mbrotjtja", por edhe të Shtypit Ushtarak në tërësi, jam i bindur se ky institucion vjen më i konsoliduar se kurrë, me orientim të qartë euroatlantik, me profil perëndimor, zëri dhe imazhi i një Force të Armatosur solide operacionale, misionare në veprim, zëri i Forcave të Armatosura Shqiptare, që kanë shkruar histori suksesi si partnere të denja në NATO.

Gëzuar 90-vjetorin e themelimit të revistës "Mbrotjtja"!



“90 VJET REVISTA MBROJTJA”

Drejtoresh e QKMBMFA Mirela Roshi: Mirënjohje të thellë për kontributin tuaj me profesionalizëm dhe përkushtimin, në ngritjen profesionale dhe cilësore të revistës “Mbrojtja”



***Fjala Përshëndetëse e Drejtoreshës
së QKMBMMFA, Mirela Roshi,
në përvjetorin e 90-të të krijimit
të Revistës Mbrojtja***

E nderuar zv. Ministre e Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici!

Të nderuar zonja dhe zotërinj, ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë ceremoni shkencore, me rastin e 90-vjetorit të krijimit të revistës "Mbrojtja".

Shtypi ushtarak e ka zanafilën e vet në majin e vitit 1931, kur dritën e botimit e pa numri i parë i revistës ushtarake "Buletini dhe e përkohshmja ushtarake". Kjo ishte e para revistë në Shqipëri, gjatë gjithë historisë 109-vjeçare të Ushtrisë Shqiptare. Në faqet e saj zunë vend artikuj të ndryshëm që kishin të bënin për ushtrinë, reformat, organizimin, protagonistët dhe modernizimin e saj, njëkohësisht u trajtuan edhe probleme teorike të ushtrisë, të teknikës ushtarake si dhe ngjarje dhe lajme të huaja. Revista dilte një herë në muaj, përmbante 24 faqe dhe u quajt e përkohshme. Ajo kishte një staf që fillonte me drejtorin, redaksinë dhe administratën, të cilët gjendeshin pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Më pas në kohë, vendin e saj e zuri "Rivista ushtarake" me 60 faqe, që ishte vazhdim i saj. U botuan numrat 78-91, vetëm në gjuhën shqipe.

Ndërsa në vitet e Luftës së Dytë Botërore kryesisht, shtypi ushtarak, në se mund të quhej kështu, u përbë nga gazetatat e botuara nga shumë formacione luftarake partizane si "Përpara në sulm", "Buçitja", "Ylli çlirimtar", "Pishtari", "Zëri i luftëtarit", "Horizonti në ndriçim", "Përpara", "Zëri i të riut", të cilat kishin kryesisht karakter politik por edhe disi ushtarak. Autorë, që me shkrimet e tyre mbushën këtë shtyp, ishin kryesisht Xhemil Frashëri, Andrea Varfi, Hamdi Sallaku, Haki Stërmilli, Shefqet Musarai etj., që më vonë u bënë shkrimtarë të njohur.



Këta ishin gazetarët e parë të shtypit të luftës të viteve '43-44'.

Pjesë e këtij shtypi ishte edhe gazeta "Mundimi", organ politik, propagandistik i aviacionit ushtarak britanik e amerikan, botohej e përjavshme me dy faqe. Gazeta më tepër ishte informative dhe botohej në Bari, por shpërndahej në Shqipëri.

Që në vitin 1945 dolën dhe organet e para ushtarake.

"Luftëtari", numri i parë doli në tetor 1944 në Tiranë. Gazetë me katër faqe, në të cilën i bëhej jehonë ushtrisë partizane, luftës për çlirimin e Tiranës dhe të vendit. Ndërsa gazeta me këtë emër doli rregullisht që nga maji i vitit 1945, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare, duke mbetur në thelb një gazetë ushtarake, me praktika, me probleme të ditës dhe kryesisht ushtarake. Gazeta e pushoi jetën e saj në vitin 1991, në kohën e ndryshimeve të mëdha demokratike që ndodhën në vend, për të vazhduar më tej me ushtrinë. Më pas u vijua botimi i saj, me tituj të ndryshëm, si "Ushtria dhe Koha" dhe që nga viti 1997

u titullua "Ushtria".

Në fund të viteve '40, shtypit ushtarak të shkruar iu shtua edhe Revista "10 Korriku", e cila ishte një revistë ilustrimi dhe më e afërt dhe më e drejtpërdrejtë me ushtarakët shqiptarë.

Ndërsa botimi më profesional ushtarak ishte "Revista ushtarake", e cila u botua në vitin 1948, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes. Revista trajtonte probleme teorike ushtarake, fjalime politike, tema dhe biseda si dhe tema të ndryshme ndërkombëtare apo edhe tema historike etj. Më pas vijoi të botohej me tituj të ndryshëm si "Revista ushtarako-politike" (1954-1967) apo "Revista politiko-ushtarake", fill pas heqjes së gradave në ushtri dhe rivendosjes së komisarëve dhe të komiteteve të partisë në ushtri.

Ndërsa revista tjetër, e titulluar "Për mbrojtjen e atdheut" nisi veprimtarinë e saj në vitin 1975, deri në vitin 1991, kur pushoi edhe ajo jetën e saj, e në thelb revista trajtonte po ato probleme dhe njëkohësisht mbeti një propaganduese e pastër e

politikës së asaj periudhe për edukimin politiko-ushtarak të kuadrove të lartë.

Ndërkohë, shtypi ushtarak përfaqësohet tashmë, nga gazeta "Ushtria", revista "Mbrojtja" por edhe "REVISTA USHTARAKE", organ tekniko-shkencor i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Autorët e shumtë, të shkrimeve të natyrave të ndryshme, që kanë botuar por edhe botojnë në të gjitha organet ushtarake, janë pambarimisht në numër por ne do t'i përkujtojmë me respekt, ata që janë larguar por edhe të tjerët që janë të pranishëm sepse ata dhanë një frymë të re dhe shumë profesionale, pasi ishin gazetarë të talentuar dhe të përkushtuar për misionin që përmbushën.

Gazetaria i ka shanset të jetojë ekskluzivisht si lajm, duke bllokuar ingranazhet e makinërisë gjigante e të pangjinur të internetit, si lajm që mendohet dy herë, para se të shtypet një herë, si lajm, i cili e pranon se lajmi më i mirë nuk është domosdoshmërisht lajmi i parë, si lajm, i cili e bllokoi rrjedhën e furishme të lajmeve në eter dhe u tregon lexuesve se çfarë është e rëndësishme e thelbësore. Me këto premisa, fati i shtypit të shkruar në Shqipëri është i sigurt dhe do të mbijetojë, madje duke u përmirësuar në thelb. Shtypi i shkruar do të mbetet në çfarëdolloj forme. Për rrjedhojë, kjo është domosdoshmëria e shtypit ushtarak dhe forma që duhet të ketë ai, një traditë që duhet të ketë vijimësi.

Të nderuar zonja dhe zotërinj, të gjithë ju, që në vite keni kontribuar për t'i dhënë jetë organeve të shtypit ushtarak, me profesionalizmin dhe përkushtimin tuaj, me përgjegjësi dhe korrektesë, ju falënderoj dhe ju shpreh mirënjohje të thellë për kontributin tuaj, në ngritjen profesionale dhe cilësore, të revistës "Mbrojtja".

Faleminderit!

Tiranë, më 15.12.2021

90-vjetori i krijimit të revistës “Mbrotjtja” histori frymëzimi për brezat e rinj

Fjala
Përshëndetëse e
Kryeredaktore
Anjeza
Musollari,
në përvjetorin
e 90-të të
krijimit të
Revistës
Mbrotjtja



Me rastin e 90 vjetorit të krijimit të një prej organeve më të rëndësishme të shtypit siç është 'Revista Mbrotjtja' u organizua Konferenca Shkencore;Mbrotjtja 90 vjet,shtypi ushtarak ndër vite.

Me pjesëmarrjen e zv.ministres Dallëndyshe Bici,drejtoreshës së QKMBMMFA Mirela Roshi dhe me një pjesë të 'pionerëve' të kësaj reviste por dhe bashkëpunëtorëve të saj ndër vite kjo konference solli në vëmendje gjithë kontributin e tyre në këtë ditë.

Me kumtues Z.Sali Onuzi, Bernard Zotaj, Zaho Golemi, dhe të tjerë bashkëpunëtorë të nderuar, historia 90 vjeçare erdhi e shtrirë në kohë si për të thënë :ata që e themeluan nuk janë mes nesh,por ata kanë lënë veprën e tyre si një përmendore të gjallë.

Respekt dhe mirënjohje pa fund për gjithë ju që nuk mundët të ishit të



pranishëm, por qe keni shenjuar vlerat tuaja

Pas konferencës të pranishmit vizituan ekspozitën me fotografi të revistës nga viti 1931-2021, rikujtuan edhe njëherë punën dhe sakrificën e tyre për të sjellë tek lexuesi ushtarak dhe jo vetem aktivitetin e Forcave të Armatosura, si një histori reflektimi për brezat që vijne pas.

Ushtria ka nevojë për shtypin e vet sepse i mban Forcat e Armatosura në kontakt të afërt me realitetin dhe me jetën ushtarake. Është pikërisht profesioni i gazetarit që jep lidhjet e plota të mjedisit dhe aktivitetëve. Është gazeta ajo që jep në mënyrën më të gjallë atë që ndodh. Studiuesit e historisë mund t'i referohen këtyre gazetave, ashtu siç edhe e kanë bërë, sepse në gazeta mbetet i fiksuar aktiviteti i ushtrisë dhe ai i një kohe të caktuar. Një kuadër që drejton ushtrinë mund ta njohë realitetin e jetës ushtarake në mënyra të ndryshme, por padyshim që një mënyrë shumë e mirë dhe efikase është informimi nëpërmjet shtypit. Ky informim mund ta ndihmojë atë për të pasur një perceptim sa më të saktë për ushtrinë. Në ushtri, duhet të ekzistojë patjetër dhe të fuqizohet ndërgjegjja. Ushtri pa pasur ndërgjegje nuk ka, sepse nuk është njëlloj si në mjedisin civil, ku mund të paguash për një shërbim të caktuar dhe dikush e bën. Në ushtri ajo që bëhet duhet të jetë e bazuar te ndërgjegjja, pasi në të kundërt nuk do të mund të arriheshin dot objektivat.

Ushtria bazohet në vetitë morale të cilat janë fuqia më e madhe e një ushtrie. Janë bërë studime të panumërta në lidhje me këtë fuqi dhe këtë gjë e ka provuar historia e njerëzimit prej mijëra vjetësh. Kohezioni, forca që e mban një ushtri është morali. Çdo drejtues duhet të studiojë elementin e moralit. Gazeta është një nga format më të mira për këtë lloj drejtimi, pasi artikujt nuk janë thjeshtë informativë por janë edhe formues. Në shtypin e përditshëm mund të



thuhet çdo gjë, por në shtypin ushtarak duhet të ketë një format i cili nëpërmjet botimeve të shkrimeve t'i shërbejë unitetit. Të gjitha këto zhvillime duhet të ecin në mënyrë

tare, u realizua shtypi duke vënë edhe kokën në rrezik, vetëm që ai të dilte në qarkullim, pasi ai ishte një armë e fuqishme. Mund të përmendet rasti i UÇK-së, e



të shëndoshë dhe t'i shërbejnë qëllimit të forcimit ushtarak. Kjo është domosdoshmëria e shtypit ushtarak dhe forma që duhet të ketë ai. Të gjitha ushtritë kanë traditën e tyre të shtypit, ashtu si dhe ne kemi traditën tonë, e cila është një traditë e lavdishme. Nuk duhet të harrojmë gjenezën tonë dhe mbi të gjitha nuk duhet të harrojmë vlagën patriotike e cila na bën të jemi shqiptarë.

Gjatë Luftës Nacional-Çlirim-

cila e krijoi shtypin në kulmin e luftës, Agjencia Kosova Press, Radio Kosova e Lirë, gazeta etj., të rrethuar nga serbët, vetëm e vetëm që të jepnin mesazhin e luftës dhe optimizmin e fitores. Pse? Sepse ishte një armë e domosdoshme e pazëvendësueshme, një armë e cila në luftë ka dalë nga gjaku, sepse ka shkruar për ata që dhanë jetën për atdheun, sepse është shkruar në llogore, mes borës e plum-

bave për të treguar sakrificën njerëzore më sublime, vetëmohimin për tokën e të parëve dhe për gjënë më të shtrenjtë, për lirinë. Nëse do të shkatërrosh një ushtri, shkatërroi moralin, shkatërroi shtypin, informimin dhe formimin edukativ, dhe ia ke dalë. Kjo është rëndësia e shtypit: Shtypi është artileri e rëndë e ndërjegjes...

Shtypi ushtarak ka historinë e vet. Kjo histori fillon në vitet e lavdishme të Luftës Nacional-çlirimtare. Ajo ishte një luftë e të gjithë popullit shqiptar, ku u ngrit i madh e i vogël për të çliruar vendin nga pushtimi. Kështu, në këtë luftë të madhe, kërkohej edhe një përgjithësim i shembullit të këtyre njerëzve që luftonin me vetëmohim. Në këtë mënyrë lindi nevoja që të kishte edhe organe

një datë krijimi të saktë sepse nuk kishte një organ të vetëm shtypi. Çdo brigadë sapo krijohej fillonte e nxirrte një buletin të vetin, një organ të vetin të shtypit. Shtypi ushtarak i mirëfilltë u krijua më 1 maj të vitit 1945, me gazetën "Luftëtari" e cila vazhdon deri më sot, me emrin e ndryshuar në vitin 1992 si "Ushtria dhe Koha", të ndërruar sërish në vitin 1997 në "Ushtria", emër të cilin ajo e mban edhe sot. Revista politiko-ushtarake "10 Korriku", u krijua në prill të vitit 1948. Edhe kjo ka pasur emra të ndryshëm: Politiko-Ushtarake, pastaj Ushtarako-Politike. Këtë të fundit, revista e mbajti deri në vitin 1992, ku e ndryshoi dhe mori emrin "Mbrojtja".

Vazhdimisht gazeta ka qenë e publikuar dy herë në javë, deri në

gazetarisë dhe shtypit ushtarak. Me përvojën dhe autoritetin që kishte, përgatiti gjenerata të tëra gazetarësh dhe intelektualësh. Ai la një emër shumë të mirë në shtypin ushtarak. Në vitet '70, pas tij, vjen Fuat Çeliku dhe në këto vite vjen një plejadë gazetarësh të mirëfilltë, ku mund të përmendim: Fuat Çelikon, Demokrat Anastasin, Hysni Milloshin, Apostol Dukën, Thanas Tanen etj., të cilët kanë punuar deri në vitet '92. Këta sollën një ndryshim cilësor në gazetarinë ushtarake dhe dhanë një frymë të re dhe shumë profesionale pasi ishin gazetarë të talentuar. Ata kishin dy elementë pozitivë: vinin nga shkolla ushtarake dhe kishin një arsim civil që i ndihmonte në gazetari.

Mirënjohje për penat e arta të shtypit ushtarak, të cilët kanë lënë gjurmën e tyre si një trashëgimi për brezat që vijnë pas. Po përpiqem të sjell në kujtesë disa prej kryeredaktorëve dhe anëtarëve të kolegjeve të revistës "Mbrojtja", sipas të dhënave të marra nga fondi i disponueshëm pranë Bibliotekës së Akademisë së Forcave të Armatosura: Safet Kurti, Dhori Panariti, Thoma Xhixho, Rahman Parllaku, Mihallaq Konda, Ridvan Dishnica, Nexhdet Deveja, Halil Xhuka, Reshat Nepravishta, Andon Kote, Mehmet Danaj, Gjin Marku, Aleks Verli, Jorgo Gumeni, Qazim Kapisyzi, Mihallaq Konda, Stiliano Sallabanda, Mina Mishaxhiu, Burhan Llukaçi, Beg Tena, Filip Rrumbullaku, Halil Katana, Pandeli Prifti, Shahin Leka, Flutura Germenji, Apostol Duka, Thoma Noti, Sazan Gjomena, Sali Onuzi, Zija Lagji, Elmaz Leci, Xheladin Çelmeta, Nexhbedin Basha, Halili Buçpapaj, Beqir Skreli, Sadik Murraj, Thanas Tane, Riza Lahii, Muharrem Dardha, Pano Hallko, Afrim Himaj, Teuta Rexhepi, Bejdo Malo, Lavdrim Lita, Dritor Papa, Albert Hitoaliaj, Mimoza Golikja, Ded Kola, Albert Zholi, Etleva Smaci, etj.



të shtypit.

Në atë kohë nuk kishte gazetarë të mirëfilltë, ata kanë qenë me kokrra. Mund të flitet për disa emra të shtypit të kohës së Luftës si: Xhemil Frashëri, Andrea Varfi, Hamdi Sallaku, Haki Stërmilli, Shefqet Musarai etj., që më vonë u bënë edhe shkrimtarë të njohur. Këta ishin gazetarët e parë të shtypit të luftës dhe bëhet fjalë për vitet '43-'44. Nuk mund të flitet për

vitet 1992 e më pas publikohet një herë në javë. Revista ka qenë vazhdimisht e publikuar një herë në muaj.

Në vitet e para kanë qenë gazetarë emra të tillë si: Xhemil Frashëri, apo Vasil Gjylameti, një gazetar që vinte nga Lufta, ish partizan i Brigadës së 3-të Sulmuese, që qëndroi kryeredaktor për një kohë shumë të gjatë. Flitet për vitet '50 deri në '74. Vasili ishte një personalitet i fushës së

“90 vjet Revista Mbrojtja”

Shtypi ushtarak në rrugëtimin e tij historik

Misioni i kësaj reviste ishte i natyrshëm që do të pasqyroste, përhapte dhe pasuronte kulturën ushtarake, në mënyrë të veçantë për kuadrot ushtarake. Revista dilte një herë në muaj dhe u quajt e përkohshme. Ajo kishte një staf që fillonte me drejtorin, redaksinë dhe administratën, që gjendeshin pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

Prof. Asoc. Dr. **Bernard ZOTAJ**,
Prof. Asoc. Dr. **ZAHO GOLEMI**,
Kolonel (R) **Sali ONUZI**


Fillesat e shtypit ushtarak shqiptar

Përpjekje për nxjerrjen e shtypin ushtarak u bënë që në qeverinë e I. Qemalit, ku u shtypën rregullore dhe u përcaktuan detyra për problemet ushtarake dhe të Forcave të Armatosura. Por pamje më të mirë dhe të organizuar shtypi ushtarak mori në kohën e monarkisë, kur filloi të shkruhej. Pas shumë përpjekjesh, në maj të vitit 1931, u arrit që të dilte numri i parë i revistës ushtarake “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake”. Kjo ishte e para revistë ushtarake në Shqipëri, gjatë gjithë historisë 90-vjeçare të Ushtrisë Shqiptare. Në faqet e saj zunë vend artikuj të ndryshëm që kishin të bënin për ushrinë, reformat, organizimin,

protagonistët dhe modernizimin e saj. Përpjekje bëheshin dhe në shtypin e ditës, që duhet thënë se ka qenë tepër aktiv për problemet e ushtrisë. Dalja e kësaj reviste u prit mirë, pasi ishte revistë dedikuar ushtrisë dhe problemeve të saj, e që dilte për herë të parë në vendin tonë. Misioni i kësaj reviste ishte i natyrshëm që do të pasqyroste, përhapte dhe pasuronte kulturën ushtarake, në mënyrë të veçantë për kuadrot ushtarake. Revista dilte një herë në muaj dhe u quajt e përkohshme. Ajo kishte një staf që fillonte me drejtorin, redaksinë dhe administratën, që gjendeshin pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Ajo doli me 24 faqe. Në faqet e kësaj reviste përmbledhej dhe buletini zyrtar, ku pasqyroheshin emërime, transferime si dhe komunikime të ndryshme. Në faqet e saj trajtoheshin problemet teorike të ushtrisë, teknike dhe ushtarake si dhe ngjarje dhe lajme të huaja. Në revistë vëmendje u kushtohej armëve të ushtrisë. Në numrin e parë zuri vend mesazhi i mbretit A. Zogu, ku porosiste që “studimi dhe stërvitja të zënë vend tek ushtaraku”.

Dalja e revistës shënonte një arritje dhe përparim në zhvillimin e ushtrisë. Drejtor i revistës u caktua Enrico Grazi, që e drejtoi me profesionalizëm deri në vitin 1933. Më pas u emërua nënkolonel Luigi Bonfatti, deri në 1934, për të vazhduar me major Leonardo Motzo, i cili e drejtoi këtë revistë deri në fund të 1937-s. në vitin 1937 stafi i revistës u ndryshua si dhe emri i saj. “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake” arriti deri në 77 numra. Vendin e saj e zuri “Revista ushtarake” që ishte vazhdim i saj, duke pasur drejtor nënkolonelin Sami Koka, duke qëndruar deri në vitin 1939.





Revista botoi nga numrat 78-91, dilte me 60 faqe, në gjuhën shqipe. Ajo vazhdoi trajtimin e problemeve ushtarake si më parë. Me pushimin fashist italian, u pushua dhe aktiviteti i saj. Në vitin 1938 doli vetëm një numër, revista "Fuqitë e Armatosura të 25-vjetorit". Revista ishte e ilustruar, me katër faqe, që u botua me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë. Kjo ishte organ i Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, me drejtor toger Shaban Strazimirin.

Shtypi në vitet e Luftës së Dytë Botërore

Ndërsa në kohën e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, në vitet 1939-1944, dolën gazeta e revista, që ishin në shërbim të

fashizmit e nazizmit, si dhe mjaft gazeta antifashiste. Viti 1944 shënon dhe vitin më të bollshëm në botimin e gazetave dhe të revistave ushtarake. Shkurtimisht po pasqyrojmë disa prej tyre që dolën gjatë Luftës së Dytë Botërore. Risi ishte se dolën dhe mjaft buletine të ndryshme, si nga lëvizja nacional-çlirimtare, nga forcat e tjera si dhe nga forcat fashiste e naziste. Të tillë ishin "Bolletino" (1940), "Buletini i jashtëzakonshëm" (1943-1944), "Buletini i Luftës Nacional-Çlirimtare" (1943-1944), "Buletini i përdyjavshëm" (1944-1945), etj.

Patë dhe revista si "Krahët e Luftës" (1941-1942), kjo e përdyjavshme, numri i parë i së cilës daton më 10 qershor 1941. Ishte një or-

gan, siç edhe u quajt, i "luftëtarëve të ajrit". Revista botohej deri në 32 faqe në shqip, gjithsej 26 numra, për të përfunduar në fundin e vitit 1942. Drejtor ishte Amedeo Mecozzi dhe shtypej në Romë. Revista "Liria" doli në Kosovë, duke qenë organ ushtarak i frontit të përbashkët nacional-çlirimtar të Kosovës dhe Metohisë. U botua në dy gjuhë duke trajtuar probleme të forcave ushtarake dhe lajme nga lufta. U botua deri nga fundi i vitit 1944. "Mundimi" ishte organ politik, propagandistik i aviacionit ushtarak britanik e amerikan, botohej e përjavshme me dy faqe. Gazeta më tepër ishte informative dhe botohej në Bari, por shpërnduhej në Shqipëri. Ajo doli deri në 38 numra, për t'u mbyllur në vjeshtën e vitit 1944.

"Përpara në sulm" ishte gazetë politiko-ushtarake e Br. I-rë S, me parullën "Në sulm, në zjarr, gjithmonë Brigada e Parë". Numri i parë doli në shkurt 1944 për të vijuar deri në fundvitin 1945. "Buçitja" ishte organ ushtarako-politik i Br. V-të S. Numri i parë doli në prill-maj 1944 dhe u botua në 3 numra. "Ylli çlirimtar", organ politiko-ushtarak i Div. I-rë S, doli në qershor 1944 numri i parë, vijoi deri në 1945. "Pishtari", organ politiko-ushtarak i Br. VIII-të S, me 48 faqe, doli vetëm katër numra dhe trajtonte problemet e luftës. "Zëri i luftëtarit", organ politiko-ushtarak i Br. IV-të S, me 20-24 faqe, doli vetëm katër numra. "Horizonti në ndriçim", organ politiko-ushtarak i Br. XII-të S, me 8 faqe, doli vetëm katër numra. "Përpara", organ politiko-ushtarak i Div. II-të S, me 40 faqe. "Zëri i të riut", organ politiko-ushtarak i Br. XII-të S, vijoi edhe në 1945. "Iriqi", organ satirik, ushtarak i Br. VI-të S, me 6 faqe, doli vetëm 2 numra. "Thumbi", organ satirik ushtarak i Br. VIII-të S, me 6 faqe, doli edhe kjo vetëm 2 numra.

Mjaft autorë partizanë, të cilët me shkrimet e tyre mbushën shtypin luftarak të kohës ishin Xhemil Frashëri, Andrea Varfi, Hamdi Sallaku, Haki Stërmilli, Shefqet Musarai etj., që më vonë u bënë shkrimtarë të njohur. Këta ishin gazetarët e parë shqiptarë të shtypit të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Zhvillimi i shtypit ushtarak në periudhën moniste

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore edhe në Shqipëri solli ndryshime në formën e organizimit të shtetit. Në pushtet erdhën komunistët, që me luftën e tyre ishin bërë pjesë e Koalicionit të Madh Antifashist dhe gjithçka e nisën nga e para. Rendi i ri politik pruri ndryshime edhe në shtypin ushtarak. Që në vitin 1945 dolën dhe organet e para ushtarake.

“Luftëtari”, numri i parë doli në tetor 1944 në Tiranë. Gazetë me katër faqe, në të cilën i bëhej jehonë ushtrisë partizane, luftës për çlirimin e Tiranës dhe të vendit. Ndërsa gazeta me këtë emër doli rregullisht që nga maji i vitit 1945, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare. Gazeta u bë një armë e fuqishme për edukimin politik, ideologjik e ushtarako-profesional, të të gjithë efektivëve të Forcave të Armatosura. Kjo gazetë e ka ndryshuar herë pas here formatin, numrin e faqeve, por në thelb mbeti një gazetë ushtarake, me praktika, me probleme të ditës dhe kryesisht ushtarake. Gazeta e pushoi jetën e saj në vitin 1991, në kohën e ndryshimeve të mëdha demokratike që ndodhën në vend, për të vazhduar më tej me ushtrinë.

Në vitet e para kanë qenë gazetarë emra të njohur si Xhemil Frashëri, Shefqet Musarai etj., gazetarë që vinin nga lufta. Vasil Gjylameti, kishte qenë partizan në Br. III-të S dhe qëndroi kryeredaktor për një kohë të gjatë. Në vitet '50 - '74 Vasili ishte personalitet i fushës së gazetarisë dhe shtypit ushtarak.

Revista “10 korriku” u botua në vitin 1947, ku doli dhe numri i parë i saj, organ i Ministrisë së Mbrojtjes. Ajo trajtonte probleme të edukimit, të jetës artistike e kulturore, të propagandës dhe të përgatitjes teorike dhe ushtarake të ushtarëve. Revista pati jetën më të gjatë dhe vijoi të dalë deri në nëntor 1991. Revista “10 korriku” ishte një revistë ilustrimi më e afërt dhe më e drejtpërdrejtë me ushtarët. Ndërsa numri i 12-të i këtij viti, dhjetor 1991, doli me emrin “Ushtria dhe koha”.

“Revista ushtarake” doli në vitin 1948, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes. Revista trajtonte probleme teoriko-ushtarake, fjalime politike, tema dhe biseda për edukimin komunist, tema ndërkombëtare, të miqësisë me BS, tema



h is - to- rike etj. “Revista ushtarake politike” kishte si mision kryesor trajtimin e problemeve të përgatitjes politike të ushtarëve dhe oficerëve. Kësaj reviste iu shtua

fjala “politike”. Prej vitit 1954 deri në vitin 1967 kjo revistë mori emrin “Revista ushtarake politike” (1954-1967). Trajtoheshin probleme në rrafshin politik, në edukimin komunist, në forcimin e ushtrisë dhe të kufijve, dhe mbi të gjitha shërbente si udhëzues për përgatitjen politike të ushtrisë shqiptare. “Revista politike ushtarake” doli në vitin 1967, pas heqjes së gradave në ushtri dhe rivendosjes së komisarëve dhe të komiteteve të partisë në ushtri. Me zbatimin e reformave të marra nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, drejtuesit e revistës menduan që të ishte e përmuajshme, duke i ndryshuar emrin e mëparshëm. Duke bërë si të thuash një rokadë të vogël mes dy mbiemrave revista nga ushtarake politike do të kalonte në politike ushtarake. Kështu në radhë të parë ishte politika, pastaj ushtria, përgatitja fizike e teorike e ushtrisë shqiptare. Revista trajtonte probleme teorike që kishte të bënte me nivelin e lartë të kadrove ushtarakë dhe politikë si komisarë dhe sekretarë të byrove e të komiteteve të partisë.

Në vitet '70, vjen një plejadë gazetarësh të mirëfilltë, ku shquhen Fuat Çeliku, Lirim Deda, Demokrat Anastasi, Hysni Millosi, Apostol Duka, Thanas Tane etj., të cilët kanë punuar deri në vitet '92. Këta sollën ndryshim cilësor në gazetarinë ushtarake dhe dhanë një frymë të re dhe profesionale.

“Për mbrojtjen e atdheut” nisi veprimtarinë e saj në vitin 1975, pas “shpartallimit të grupeve puçistë” në ushtri, dënimit të ministrit dhe gjithë stafit të lartë ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, revista mori këtë emër. Revista e mëparshme funksionin e saj politik nuk e kishte luajtur sa duhet dhe “armiku e kishte bërë punën e vet sabotuese” në faqet e saj. Ndaj dhe drejtuesit e rinj ndërruan emrin e revistës teorike, politike, luftarake, ushtarake.

Nga viti 1975 deri në vitin 1991, kur pushoi jetën e vet, kjo revistë, kishte emrin “Për mbrojtjen e atdheut”. Në thelb revista trajtonte po ato probleme dhe mbeti një propaganduese e pastër organeve të partisë për edukimin politiko-



ushtarak të kuadrove të lartë. Pas vitit 1991, revista mori një emër të ri "Mbrojtja", emër me të cilin botohet aktualisht.

Në revistën "Mbrojtja" kanë dhënë ndihmesë si kryeredaktorë dhe anëtarë të kolegjumit mjaft ushtarak të kualifikuar për gazetari, ku mund të përmendim emra që kanë spikatur, që nga e vitet e para të revistës e në vazhdim si: Safet Kurti, Dhori Panariti, Thoma Xhixho, Rahman Parllaku, Mihallaq Konda, Ridvan Dishnica, Nexhdet Deveja, Halil Xhuka, Reshat Nepravishta, Andon Kote, Mehmet Danaj, Gjin Marku, Aleks Verli, Jorgo Gumeni, Qazim Kapisyzi, Mihallaq Konda, Stiliano Sallabanda, Mina Mishaxhiu, Burhan Llukaçi, Beg Tena, Filip Rrumbullaku, Halil Katana, Pandeli Prifti, Shahin Leka, Flutura Germejni, Apostol Duka, Thoma Noti, Sazan Gjomena, Sali Onuzi, Zija Lagji, Elmaz Leci, Xheladin Çelmeta, Nexhbedin Basha, Halili Buçpapaj, Beqir Skreli, Sadik Murraj, Thanas Tane, Riza Lahi, Muharrem Dardha, Pano Hallko, Afrim Himaj, Teuta Rexhepi, Bejdo Malo, Lavdrim Lita, Dritor Papa, Albert Hitoaliaj, Mimoza Golikja, Ded Kola, Albert Zholi, Etleva Smaci, etj.

Shtypi ushtarak në fillimet e demokracisë

Në vitin 1992 doli numri i parë i gazetës "Ushtria dhe koha", në formatin A3, me 8 faqe e më pas me 16



faqe. Kjo gazetë vijoi të trajtonte problemet ushtarakë, të para në këndvështrimin e ri politik e shoqëror të vendit, mjaft e çliuar politikisht. Gazeta ushtarakë trajtonte probleme të ndryshme, që kishin të bënin me jetën ushtarakë si dhe me traktatet, aleancat, misionet dhe organizimin e ri të ushtrisë shqiptare, sipas kërkesave të kohës. Vijoi botimin deri në marsin e vitit 1997. "Ushtria dhe koha" ishte një tjetër revistë që doli në vitin e vështirë ekonomik 1992, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si vijim i revistës "10 korriku". Paralelisht, po me këtë emër, dilte edhe gazeta tjetër e ministrisë. Kjo revistë e pati jetëgjatësinë e saj vetëm një vit e gjysmë dhe nga fillimi i vitit 1993 pushoi së ekzistuari.

"Ushtria", gazetë ushtarakë e dalë në vitin 1997 pas trazirave që ndodhën, për shkak të ndryshimeve politike në vend. Stafii drejtues i ri i ndryshoi emrin gazetës, duke e quajtur thjesht "Ushtria". Misioni i gazetës ishte pasqyrimi i reformave dhe ndryshimeve në ushtri. Gjatë kësaj periudhe një vend të rëndësishëm në faqet e gazetës zuri Lufta e Kosovës dhe gjithë zhvillimet e saj. Njëherësh kjo gazetë priti dhe shekullin e ri, ku u bë frymëzuese, aspiruese e mbështetëse e objektive të Ushtrisë Shqiptare për të qenë pjesë e NATO-s, gjë që u arrit me shumë dinjitet. Sot kjo gazetë

vijon misionin e saj, me këtë emër, si një organ dinjitoz i një Force të Armatosur po aq dinjitoze. Kjo gazetë, nga marsi i vitit 2014, botohet elektronikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në kushtet kur Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm, detyrë kryesore kishte procesin e mësimdhënies, ndërkohë ajo ishte edhe një qendër e rëndësishme shkencore e ushtrisë.

Ministri i Mbrojtjes nxori urdhrin Nr. 15, datë 18.01.1992, për botimin e "Revistës Ushtarakë" si organ teoriko-shkencor në Akademinë Ushtarakë të Shtabit të Përgjithshëm. Objekti kryesor i revistës ishte zberthimi e trajtimi teoriko-shkencor i problemeve kryesore të artit ushtarak në shkallë të ndryshme, të historisë ushtarakë të vendit tonë dhe të shteteve të huaja, si dhe tema të përvojës, të teknikës e armatimit bashkëkohor të ushtrive të huaja dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën politiko-ushtarakë. Revista kishte kolegjiunin e saj të përbërë prej 21 vetash dhe kryeredaktor ishte Nënkolonel Xhemil Çela. Revista Ushtarakë pati një jetëgjatësi të shkurtër 3-vjeçare, por përsëri ndërpreu aktivitetin e saj.

"Mbrojtja" ishte një tjetër organ profesional që pa dritën e botimit pranë MM. Revista "Mbrojtja" doli në numrin e parë të saj në mesin e vitit 1992. Kjo revistë u formatua nga një staf i ri, me emra të rinj, me vizione të reja dhe shumë shpejt revista u bë pararojë e ndryshime të domosdoshme edhe në ushtrinë shqiptare. Revista ishte në shërbim të ushtarëve, të problemeve të tyre, më e çliuar, më shumë argëtuese, edukative dhe informuese.

Breth shtëpisë botuese të Forcave të Armatosura

Shtëpia botuese e FA-së, si një institucion botues i krijuar më 24 tetor 1991, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, duke qenë pjesë e sistemit të saj. Shtëpia kishte karakter enciklopedik dhe vepronte me cikël të plotë nga planifikimi, përpunimi, administrimi e

shpërndarja, deri te propagandimi i botimeve. Fillimisht kishte një efektiv prej 21 punonjësish, ushtarakë e civilë të specializuar. Drejtori i parë ishte gazetari e shkrimtari, kolonel Fuat Çeliku. Shtëpia botuese bënte botime të karakterit ushtarako-shkencor, doktrinar, pedagogjik-metodik, socio-psikologjik, mësimor, historik, gjuhësor, kulturor, letrar-artistik etj., e profilizuar për nevojat e përgatitjes së gjithanshme moralo-luftarake, për motivim dhe ngritjen e nivelit teorik, profesional e intelektual të efektivëve të FA-së. Gjatë viteve 1991-2001 shtëpia botuese realizoi mbi 250 botime, me një tirazh të përgjithshëm prej 260.000 ekzemplarësh si doktrina ushtarake, vepra klasike e bashkëkohore të artit ushtarak, rregullore, manuale, tekste mësimore, buletine, monografi të shumëllojshme, fjalorë shumëgjuhësh terminologjik e gjuhësorë, studime të karakterit sociologjik e të drejtimit ushtarak, vepra historike për ushtritë e luftërat, romane, vëllime me tregime, poezi e publicistikë etj. Një pjesë e botimeve të kësaj periudhe, për shkak të nevojave të proceseve të transformimit të FA-ve, janë përkthime të autorëve e të institucioneve prestigjioze perëndimore, duke sjellë mendimin e përvojat më të përparura botërore për ushtrinë, mbrojtjen dhe shkencën ushtarake në kushtet e sistemit demokratik e të integritimit në strukturat euroatlantike.

Ringritja e ushtrisë dhe shtypit ushtarak pas vitit 1997

"Revista Mbrojtja", organ ushtarak-kulturor i Ministrisë Mbrojtjes, kështu u quajt nga stafi i ri revistës "Mbrojtja", që erdhi në krye të MM, në vitin 1997. Kështu në emërtimin e revistës u përfshi dhe fjala "Revista". Me këtë emër "Revista Mbrojtja" është bërë një organ i specializuar ushtarak, periodik, në formatin A4, me 54 faqe me ngjyra, duke vijuar traditën e botimit deri më sot. Nga marsi i vitit 2014 kjo revistë botohet elektronikisht.

Në vitin 2002 nisën botimin një

sërë gazetash dhe revistash të Forcave dhe Komandave Mbështetëse, për informim të brendshëm të njëjësive dhe reparteve të këtyre njëjësive. Misioni i tyre ishte pasqyrimi i gjithë aktiviteteve të Forcave dhe Komandave Mbështetëse, publikimi i planeve të transformimit dhe modernizimit të tyre, si dhe historikut, veprës së brezave të mëparshëm dhe të dëshmorëve e heronjve të tyre. Të tilla gazeta ishin "Fjala e



Tokësorit" gazetë e Forcave Tokësore, si dhe revista "Forcat Ajrore", revista "Detari", revista e Komandës Mbështetëse etj.

Me reformimin e ushtrisë dhe konsolidimin e Forcave të Armatosura u krijua Komanda e Doktrineve dhe e Stërvitjes, ku në përbërje të saj u krijua dhe dega e botimeve, si organizëm më vete, në përbërje të Qendrës së Doktrineve, Manualeve dhe Botimeve, sot Qendra e Doktrines dhe Kërkimit. Një nga detyrat kryesore të saj ishte dhe botimi i Revistës Ushtarake si organ teoriko-shkencor i Komandës së Doktrines dhe të Stërvitjes, e cila do të luante rol parësor për shkëmbimin e lirë të mendimeve nga kadri oficer, për trajtimin e materialeve teoriko-

shkencore, etj. Qëllimi i saj ishte të kontribuonte në zberthimin e trajtimin sa më shkencor të teorisë e të doktrines sonë ushtarake në përputhje me kushtet e zhvillimit bashkëkohor, të ndihmojë kuadrin oficerë në zgjerimin e njohurive të tyre ushtarake, sidomos atyre të shtabeve e të reparteve, akademistëve e studentëve. Ajo synonte në zhvillimin bashkëkohor të shkencës ushtarake. Revista i parapriu dhe i hapi rrugë mendimit të lirë debatues e në frymë konstruktive, për idetë, mendimet e trajtuara nga autorë të ndryshëm si bashkëpunëtorë të revistës.

Në vitin 2002 revista ushtarake pa dritën e botimit në dy numra të saj. Në to u trajtuan probleme të politikës së sigurimit e të mbrojtjes, koncepte doktrinare e të stërvitjes, probleme të historisë ushtarake e të terminologjisë, probleme të arsimit ushtarak, trajtesa të kolegjit të mbrojtjes etj., me rreth



40 artikuj të shkruar nga gjeneralë, profesorë, pedagogë, kadro, akademistë e studentë. Në vitin 2003 në Revistën Ushtarake kanë shkruar artikuj që nga Presidenti, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Shefi i

Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, si dhe gjeneralë, profesorë, veteranë, komandantë të llojeve të armëve e shërbimeve e figura të tjera publike të vendit dhe të ushtrisë. Në vitin 2003 Revista Ushtarake pa dritën e botimit në katër numra dhe janë shkruar rreth 80 artikuj. Pas kërkesës së bërë nga ish Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes gjeneralmajor Perlat Sula dhe oponencës së bërë nga Prof. Proletar Hasani, Komisioni i Kualifikimit Shkencor pranë Këshillit të Ministrave, e klasifikoi Revistën Ushtarake si revistë shkencore më datë 10 dhjetor 2003. Numri i parë i vitit 2004 i Revistës Ushtarake hyri në histori si numër i klasifikuar shkencor, në bazë të ligjeve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë dhe si e vetmja revistë shkencore në FA. Kjo revistë doli deri në fund të vitit 2005, për të vazhduar përsëri nga viti 2008 dhe deri më sot.

“Krenaria ushtarake”, gazetë e Shoqatës së Bashkuar të Ushtarakëve në Rezervë që nisi botimin në vitin 2000. Gazeta kishte 16 faqe dhe doli në 28 numra, duke trajtuar kryesisht probleme të ushtarakëve në lirim e në rezervë si dhe probleme të së kaluarës. Vijoi botimin deri në vitin 2008. “Zëri i ushtarakut” nisi botimin në vitin 2009, si gazetë me vete, pasi më parë dilte si suplement ushtarak i gazetës “Ndryshe”. Gazeta trajtonte problemet e ushtarakëve të liruar, kryesisht. “Aleanca ushtarake” ishte gazeta ushtarake, organ i Aleancës Kombëtare të Ushtarakëve të Shqipërisë dhe filloi botimin në mesin e vitit 2010, si një gazetë periodike me 12 faqe. Gazeta trajtonte edhe kjo probleme të ushtrisë dhe jetës së ushtarakëve si dhe probleme të ndryshme kulturore kombëtare e ndërkombëtare.

“Revista Studime për Historinë Ushtarake”, organ shkencor i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake, nisi botimin në vitin 2006. Në faqet e kësaj reviste kanë gjetur pasqyrim studimet shkencore në fushën e Historisë Ushtarake

Shqiptare, si botime e promovime librash shkencorë, tekste mësimore për shkollat e akademitë ushtarake, monografi, materiale shkencore dhe njohëse për studimin, evidentimin dhe publikimin e dukurive, ngjarjeve dhe të personaliteteve të Historisë Ushtarake Shqiptare e më gjerë (në rajon) etj., organizim

në detyrën e shefit të propagandës dhe të shtypit ushtarak.

Shkrimin e parë në gazetën “Luftëtari” e ka botuar në vitin 1956, për të vazhduar këtë rrugë gjatë gjithë karrierës së tij ushtarake në organet e shtypit ushtarak. Ka botuar libra me bashkautorë. Në libra dhe në shkrimet e vijueshme



seminarësh, sesionesh dhe konferencash për diskutimin dhe bërjen të njohur, të dukurive e risive të ndryshme apo të studimeve me karakter shkencor dhe edukativ nga fusha e Historisë Ushtarake etj.

Disa portrete të drejtuesve të shtypit ushtarak në vite...

Hamza Malaj dhe korifentë e shtypit ushtarak. Hamza Malaj ka lindur në Brataj të Vlorës në vitin 1935. Me përfundimin e shkollës fillore në vendlindje, nisi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” në tetor 1947. Shkolën e Bashkuar të Oficerëve e përfundoi në nëntor 1953 dhe mori gradën e nëntogerit. Emërohet në Brigadën e 5-të të Këmbësorisë Malore “Kurveleshi”, me detyrë përgjegjës i Rinisë së batalionit. Në dhjetor të vitit 1957 transferohet në ishullin e Sazanit në detyrën e përgjegjës të Rinisë për Ishullin. Më 20 Tetor 1960 emërohet në Drejtorinë Politike të Ushtrisë në Ministrinë e Mbrojtjes,

ka trajtuar tema për vendlindjen, atdhetarizmin, LANÇ-in, për patriotë dhe luftëtarë, probleme të shtypit ushtarak, si dhe probleme të përditshme të shoqërisë.

Në shtypin ushtarak krijues letrarë më të preferuar kanë qenë të gjithë ushtarakët që shkruanin në vijimësi. Të gjithë kanë qenë të mirë, por gjithmonë kam veçuar letrarët, ku secili ka pasur dhe veçoritë e veta. Të përbashkët ata kishin lëvrimin e temës heroike, zakonisht Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ku gjenin shumë simbole që i frymëzonin. Hamzain gjithmonë e ngacmonte lirizmi i hollë e drithërues i Lirim Dedës, humori krejt i natyrshëm e origjinal i Halil Lazes, heroizmi buçitës deri në kupë të qiellit i Hysni Milloshit, apo edhe ëmbëlsia karakteristike e krijimtarisë së tij, që e paraqiste krejt origjinal, apo Bashkim Kozeli që ishte një nga dramaturgët më të spikatur të ushtrisë. Të gjithë bashkë, kanë formuar një simfoni, të cilën, kush e ka prekur është magjepsur. Teksti i

këngës "Gjurmë të arta", shkruar Lirim Deda mbeti e artë. Po kënga "Nën-o, moj, do pres gërshetin" e shkruar nga Hysni Milloshi, mjafton që brezat e ardhshëm të mësonin epopenë e madhe të këtij populli. Po nuk harrohen kompozitorët Laro e Mula. Hysni Milloshi mbetet një prush i zjarrtë.




Hysni Milloshi, me disa shënime të drejtorit të Ndërlidhjes së Ushtrisë, Kadri Brahimajt, mbi dëshmorët e ndërlidhjes, shkroi për ta një libër. Zgjodhi Hysniun për ëmbëlsinë me të cilën ai i vishte personazhet. Dëshironte Hamza Malaj që dëshmorët, veç respektit e nderimit, të jetonin dhe në ëmbëlsinë e penës së Hysniut. Libri "Kujtimet e një ndërlidhësi", botim i Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë, u mirëprit nga lexuesit e shumtë.

Puna e gjatë me rininë, si në reparte ashtu dhe në Drejtorinë Politike, puna me krijimtarinë artistike po në Drejtorinë Politike dhe në fund, puna në shtypin ushtarak, bëri që edhe Hamza Malaj të mësonte diçka. Letërsinë e donte, librat i lexonte me shumë dashuri. Në shtypin ushtarak,

shkruante dhe vetë. Por Hamza Malaj në pikëpamje profesionale, nuk mund të krahasohej me Vasil Gjylametin, Dhori Shkodranin, Lirim Dedën e Hysni Milloshin. Në gazetën "Ushtria", nga mesi i viteve '90-të, të shekullit XX, Halil Laze, që padrejtësisht provoi ferrin e burgut, shkruante se për fat të mirë në këtë kohë erdhi në drejtim të shtypit ushtarak Hamza Malaj, një intelektual i formuar që mund të drejtonte gjithë shtypin kombëtar.

Halil Lazja ka qenë një njeri i shkëlqyer. Megjithëse padrejtësisht u dënua me



burg, ai asnjë herë nuk e vuri në dyshim dashurinë për ushtrinë e për atdheun. Ai arriti të dalë i gjallë nga tmerri i burgjeve. Halil Lazja ishte djalë dëshmorë. Po sistemi i asaj kohe, hëngri djemtë e tij.

Lirim Deda, gazetari dhe poeti i shquar ushtarak. Lirim Deda ka lindur në Nivicë të Kurveleshit, Tëpelenë, më 16 shkurt 1936. Shkollën fillore e kreu

në vendlindje, kurse shtatëvjeçaren dhe gjimnazin në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", në Tiranë. Mbaroi studimet për oficer në Shkollën e Bashkuar, si dhe studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi Shqipe. Në vitet 1961-1965 ka punuar si gazetar i kulturës në shtypin ushtarak dhe pastaj deri në vitin 1969 u dërgua në Shkodër, Kukës, Tropojë, si sekretar i rinisë i Korpusit të Veriut. Rikthehet në shtypin ushtarak, kryeredaktor i Revistës "10 Korriku" në vitin 1973. Punoi në detyrë deri në vitin 1975. Lirimi ka qenë anëtar i kolegjiut të gazetës "Drita", si dhe anëtar i Komiteti Drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë. Ka punuar në Sopot të Librazhdit në brigadat e punës deri në vitin 1990.

Në vitet 1990 punon redaktor në gazetën "Fjala e lirë" dhe në gazetën "Ku vemi". Më tej punon si redaktor në Shtëpitë botuese "Onufri", "Egnatia" e "Xhuvani". Zgjidhet dhe kryetar i degës së Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të rrethit të Elbasanit. Në vitet 2000-2012 punoi si kryeredaktor i gazetës "Labëria". Ka qenë bashkëpunëtor i gazetës "Ndryshe". Ishte anëtar i kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Ishte redaktor në Shtëpinë Botuese "Alsa".

Librin e parë me poezi dhe poema "Këngët e marshimeve"

e botoi në vitin 1966 dhe pastaj me radhë: "Miqve dhe armiqve" 1968, "Në vijën e patrullimit" 1969, "E dua këtë tokë" 1970, "Kolana e poezisë së zgjedhur shqipe" 1970, "Tregimet e Veriut" 1971, "Zambakë nga Hanoi" 1972, "Kënga e fitimtarëve" 1973, "Shënime për shokët letrarë"

(shënime kritike, 1974), "Në Kinën e madhe" (reportazhe, 1974), "Baladë vietnameze" (reportazhe, 1979), "Zëri i tokës" 1980, "Gjurmë të arta" 1995, "Eja të blesh zemrën time" 1996, "Rrufe pikëllimi" 1997, "Trëndafili i zi" 1998, "Bukuria të verboka" 1999, "Djepvarri im, trimja Labëri" 2002, "Kush e vrau dashurinë" (shënime kritike-2006). Romanet: "Foleja e vetëtimitave", 2009 dhe "Valle në shtëpinë e vdekjes", 2011.

Në festivalet mbarëkombëtare të Radio Televizionit Shqiptar, si dhe në festivale të ndryshme të folkut e muzikës nëpër rrethe si në Gjirokastër, Shkodër e Elbasan, Lirim Deda si autor i teksteve ka fituar këto çmime të para: "Gjurmë të arta", Kujtim Laro, L. Deda në Festivalin e 12-të të Këngës në RTSH; "Lulëkuqja", Limos Dizdari, L. Deda, në Festivalin e 13-të të Këngës në RTSH; "Për ty Tiranë", Avni Mula, L. Deda; "Sa 100 shqiponja", R. Zdrava, L. Deda; "Kënga e zëmrave", Alfons Balliçi, L. Deda; "E dua këtë tokë", Prenk Jakova, L. Deda; "Dy milionë ushtarë", Çesk Zadeja, L. Deda

Bashkim Kozeli, ushtarak dramaturg. Bashkim Kozeli ka lindur në vitin 1942, në Ersekë. Shkollën fillore dhe uniken i kreu në shkollën 7-vjeçare "11 Janari" në Tiranë. Pasi mbaroi Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", vazhdoi studimet për pilot në ish-Bashkimin Sovjetik, por i ndërpreu ato për arsye shëndetësore. Më pas u arsimua për sinoptikant, profesion të cilin e ushtroi për disa vite si pedagog në Shkollën e Aviacionit në Vlorë. Angazhimi i tij i suksesshëm në letërsi, kryesisht në dramaturgji, bëri që në vitet në vazhdim të punonte në sektorët e kulturës dhe edukimit në radhët e ushtrisë, deri në drejtor i Drejtorisë të Edukimit të Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes gjatë viteve 1992-2000.

Për mjaft kohë ka qenë shkrimtar në profesion të lirë. Mbi dhjetëra drama të Kozelit janë vënë në skenë nga teatrot profesioniste të Vlorës, Gjirokastrës, Fierit, Korçës, Shkodrës (katër prej të cilave edhe në Teatrin Kombëtar (Popullor). Ndër to mund të përmendim "Shokët" (1968), "Sinjali i kuq" (1971), "Si u kalitëm" (1974), "Lidhur si fishekë gjerdani" (1981), "Troket historia"

(1982), "Buzëqeshjet e një mbrëmjeje" (1985), "Pavdekësi" (1987), "Ustai" (1995), "Ora e mbetur" (2007), "Ëndrra e Ismail Qemalit" (2012), "Nanë Tereza kur ishte Gonxhe", (2016). Ai është skenarist i disa filmave artistike të Kinostudios "Shqipëria e Re", si "Në emër të lirisë" (1987), "Pas takimit të fundit" (1989), "Pleqtë e hashashit" (2010), si dhe seriali televiziv me dhjetë pjesë në RTSH "Dhimbja e dashurisë" (2009). Ai ka fituar disa herë çmime e urdhra si dhe vendin e parë në konkurset kombëtare të dramës në vendin tonë. Gjithashtu ai është autor i mjaft librave me poezi dhe shkrimeve për etikën dhe kulturën.

Halil Katana dhe lufta e UÇK-së. Lindi në fshatin Degë të rrethit të Tropojës më 15 dhjetor 1939 në një familje me taban të hershëm atdhetar. Halil Katana ka punuar për hapjen e Rrugës së Dritës në vitin 1952, kur ishte vetëm 13 vjeç, në kantierin e Hidrocentralit të Ulzës në vitin 1955 dhe në hapjen e rrugëve Shëmri-Kolgecaj, të Malësisë së Madhe, të Komanit dhe në Hekurudhën e Përrenjasit.

Ka mbaruar Shkollën Ushtarake "Skënderbej" dhe Shkollën e Lartë të Oficerëve "Enver Hoxha", me rezultate të shkëlqyera duke u titulluar me gradën ushtarake "Toger". Ka ndjekur Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm në vitet 1964-1966. Ka bërë dhe një kualifikim pasuniversitar në Fakultetin e Gjuhë-Letërsisë, në Universitetin e Tiranës, si dhe ka kryer Shkollën e Lartë të Partisë në vitet 1985-1988. Halili fillimisht ka kryer detyrën e komandantit të Batalionit Autonom, i Qendrave të Ndërlidhjes në Koman-dën e Përgjithshme, ndërsa më pas pedagog i Ndërlidhjes në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" në Tiranë.

Në fushën e publicistikës, gjatë viteve 1981-1992 ka qenë gazetar në revistën teorike të Ushtrisë "Për mbrojtjen e Atdheut". Në periudhën 1997-2000 ka qenë kryeredaktor i revistës "Mbrojtja", organ i Ministrisë së Mbrojtjes. Gjatë kësaj periudhe ka kryer detyrën e drejtorit të Shtypit Ushtarak Shqiptar. Si ushtarak i lartë, mbante gradën Kolonel.

Mbas vitit 1990, Halil Katana caktohet kryeredaktor i gazetës periodike "Për Mëmëdhenë", organ shtypi i Shoqatës "Për të Rënë e Kombit". Nga viti 1996 filloi e punoi edhe për revistën "Pavdekësia", botim i OKDA.

Ka botuar studime dhe libra të ndryshme si "Radioteknika" (pjesa e parë dhe e dytë), "Bazat teorike të radioteknikës" dhe "Bazat e elektronikës". Më tej, panë dritën e botimit vëllimet: "Isa Boletini-strateg i luftërave kryengritëse", "Për ata që u kthyen nga lufta fitimtare", "Në ditët e pranverës së madhe", "Stërvitja e paqes", "Flamuri - kryesimbol i kombit", "Kudusi Lame - gjeneral i luftës", "Tri dimensionet e luftës çlirimtare të Kosovës", "Ringritja e ushtrisë shqiptare 1997-2000". Nga viti 2002 ka qenë kryeredaktor i revistës "Pavdekësia", organ i Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e Atdheut. Vdiq më 19 qershor 2012 në Tiranë.

Agim Hila, një jetë në shtypin ushtarak. Agim Hila ka lindur në Gjirokastër në vitin 1944, ku kreu arsimin 8-vjeçar. Në vitet 1960-1964 përfundoi shkollën "Skënderbej". Në vitit 1966 përfundon Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në degën e Artilerisë Tokësore.

Ka punuar në Korpusin e Burrelit si oficer artilerie në zbulim në brigadën e Burrelit, më pas në Peshkopi shef i shtëpisë së oficerëve, i kulturës dhe i propagandës deri në vitin 1978, ku përfundon dhe Universitetin e Tiranës për gjuhë-letërsi me korrespondencë.

Pas vitit 1978 ka punuar në Tiranë, drejtor i Estradës së Ushtarit. Përfundon kursin e filozofisë në vitin 1980. Ka punuar në trupën artistike të Ushtrisë dhe në Ministrinë e Mbrojtjes redaktor letrar në sektorin e botimeve. Në vitet 1998 ka punuar gazetar në revistën "Mbrojtja".

Ka botuar 12 libra në poezi, në prozën e shkurtër, tregime e novela, ku ka marrë dhe çmime. Ka qenë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të

Shqipërisë nga viti 1975.

Gazetat dhe revistat e FA-së kanë qenë dhe mbeten një dritare informuese, në ndonjë periudhë edhe e censuruar, edhe për vetë Forcat e Armatosura, ndërkohë që sot misioni i komunikimit me opinionin publik, është thelbësor e jetik që opinioni, të mësojë më shumë për misionin e Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit, edhe në kuadrin e angazhimeve në NATO. Në misionet ushtarake por edhe në misionet civile të kontributit me shumë vlerë të FA-së në emergjencat civile, në mbrojtje të popullatës nga fenomenet ekstreme të natyrës, përmes gazetarisë shpaloset dimensionin dinamik i FA-së, si dhe nga ana tjetër promovohet imazhi i Forcave të Armatosura.

Në këtë kuadër gjykoj se imazhi dhe fytyra e Forcave të Armatosura sot duhet t'i ngelet historisë krahas materialeve elektronike edhe në materiale në versionin e printuar, që Biblioteka Kombëtare, bibliotekat e Akademive, institucioneve të arsimit të kenë mundësi të lexohen edhe nesër edhe pas dhjetëra e qindra vjetësh në gjeneratat e së ardhmes së strukturave të mbrojtjes dhe sigurisë në vend, pse jo të riaktivizohet edhe revista në gjuhën angleze "Albanian Armed Forces", ndoshta si suplement, për homologët e vendeve të NATO-s. Nga ana tjetër shërbimi në FA i burrave dhe grave nën uniformë nuk është vetëm një "treg pune", por një mision i idealistëve e atdhetarëve, një copëz e ndërgjegjes kombëtare e shtetarëve shqiptarë, që meritojnë vëmendje dhe që gazetarët e spektrit ushtarak duhet të "vjin" aktivitetin jetësor të FA-së, misionin, përditshmërinë e tyre dhe ta derdhin në rreshta të shkruar e të lexueshëm për të gjithë. Prandaj edhe vëmendja dhe mbështetja ndaj këtyre gazetarëve dhe krejt shtypit ushtarak në tërësi duhet rritur nga strukturat udhëheqëse të MM, SHP dhe komandat vartëse të tyre. Trinomi që trupëzon ushtarin dhe oficerin shqiptar për shek-



ullin XXI "Detyra-Nderi-Atdheu", kërkon vijimësi e standardizim në shtypin ushtarak, profesionalizëm që lexuesi i shtypit ushtarak të rritet përtej strukturave të mbrojtjes, që me cilësinë aktuale është premtuese në të ardhmen.

Gazetari i shtypit ushtarak të shekullit të XXI-të, jemi të bindur se do të jetë në një hap dhe misionar i përbashkët me strukturat ushtarake të standardizuara, që të shpjegojë thjeshtë e qartë specifikat e kohës sonë përtej konvencionalitetit, taktikave dhe strategjive, duke u përshtatur me teknologjitë e sofistikuara informatike, duke i bërë

mjetet informacionit më të vlerësuara nga komandat ushtarake dhe lidhshipi politik ushtarak i vendit. Mbështetja e sektorit mjaft të rëndësishëm të publikimit të shtypit ushtarak, si misionarë të një epoke të re, për të bërë që Forcat e Armatosura të jenë më pranë njerëzve, për atë që bëjnë, për historinë që shkruajnë në përditshmërinë e kontingjentëve ushtarake në rajone të ndryshme të botës, në krahë të aleancës, për detyrat cilësisht të realizuara dhe për një forcë të vogël por dinamike që sa herë ka nevojë vendi është pranë halleve të popullit në zjarre, në përmbytje, në tërmete, në stërvitje e marshime. Bashkë me ta është shtypi ushtarak, që

mbrapa nuk ka sot një makineri gjigande propagande, por profesionistë, që me performancën e tyre e ngrenë më lart krenarinë e shtypit ushtarak shqiptar të dokumentuar. Sugjerimi i disa brezave gazetarësh dhe jo vetëm në këtë 90-vjetor është një kërkesë modeste që e duan gazetën "Ushtria" dhe revistën "Mbrojtja" edhe në versionin "print", me numër ISSN-je si dhe në pamundësi të një sasive të madhe revistash e gazetash ushtarake, numri limit për Bibliotekën Kombëtare, bibliotekat e institucioneve ushtarake si dhe AQSH dhe AQFA-në është detyrim brezash.

MIRËNJOHJE!

Mirënjohje për Ministrinë e Mbrojtjes!

Mirënjohje për organizatorët që na mblodhën!

NGA: SAKIP CAMI

Respekt për kryeredaktorin Thanas Tane, gazetar brilant, dalë nga shkolla ushtarake dhe Fakulteti i gazetarisë. Unë pata fatin të punoj me të dhe me Afrimin, Xheladinin, Agustinin, Nexhbedinin si dhe me kolegët e revistës, kryeredaktorin, kolonel Halil Katana, me Sadik Murrajin, Halil Buçpapën e të talentuarin Kosta Raka, në vitet 1999-2003, pikërisht në kohën e luftës së Kosovës e të prezencës së NATO-s me AFOR e KFOR. Gazeta hapej me tituj si "Tym e flakë në Qafën e Morinit". Ajo u bë zëdhënëse e UÇK-së me shkrimet e saj, me raportimet e Shpëtim Golemit (Dilaver Goxhaj) direkt nga Shtabi i UÇK-së, me raportimet e Asllan Osmanit nga kufiri i Tropojës, nga raportimet e Azem Parllakut nga kufiri i Kukësit. Ishte koha kur gazetarët e dërguar nga gazeta "Ushtria" dhe




revista "Mbrojtja", Xheladin Çelmeta dhe Sadik Murraj rrezikuan jetën në frontin e Kukësit nga predhat serbe. Ishte koha kur Gjenerali Klark vinte vetë në Tiranë për të takuar liderët e Tiranës. Ishte koha kur ministri i Mbrojtjes Luan Hajdaraga dhe shefi

i Shtabit Gjeneral Aleks Andoni ishin zhvendosur në kufi. Mirënjohje pa fund për ju shokët e mi gazetarë të luftës, profesionistë në gazetari dhe si ushtarakë. Mirënjohje për drejtorin e shtypit ushtarak gazetarin dhe nënkolonelin Beqir Skreli!



Fotografë dhe piktorë të shtypit ushtarak ndër vite




Fotografia,
arti i
përjetësimit
të figurave
që historia
lë pas



Mediat e shkruara apo në përgjithësi të gjitha mediat janë një segment shumë i rëndësishëm i një vendi, për arsye që gjithmonë dërgojnë tek publiku informacionet e rëndësishme apo të nevojshme rreth ngjarjeve që ndodhin apo dhe promovimeve të njerëzve të cilët spikasin në fushën e tyre. Gazetaria me artin e saj ka bërë që historia njerëzore të vijë ndër breza si një pasqyrim i jetës në kohëra të ndryshme. Kështu ne sot gëzojmë një botim me një histori të largët,

e krijuar nga pak letër, një penë dhe zemra që kërkonin të bënin revolucion atëherë kur ishte e pamundur. Kështu erdhi në jetë revista "Mbrotjtja", mes sakrificash të mëdha shtypi ushtarak po hidhte hapat e tij të parë. Një plejade e tërë gazetarësh, fotografësh, piktorësh, bashkëpunëtorësh të cilët na lanë një trashëgimi të vlerë. 90 vite punë, krijimtari, vlerë. Kështu do të shpreheshin disa prej atyre njerëzve që bënë historinë e tyre në këtë revistë, jo vetëm mes fjalëve por dhe me artin e pikturës dhe fotografisë.





Marrë nga revista "10 Korriku", 1982

Nikolin Pici, pjesë e dinastisë së fotografëve shkodranë

Mjeshtri i fotografisë Nikolin Pici, ishte një nga pjesëtarët e dinastisë së fotografëve shkodranë "PICI". Nikolin Pici lindi në Shkodër më 24 tetor 1940. Ai i përket brezit të fotografëve shqiptarë të gjysmës së dytë të shek. XX me traditë familjare.

Nikolin Pici ishte pjesë e grupit të fotografëve të Laboratorit Fotografik Qendror të Ushtrisë Shqiptare që në moshën 18-vjeçare dhe pas 11 vjetësh (1959-1970) ai do të kalonte si fotograf i revistës së ilustruar ushtarake "10 Korriku" (1970-1990). Gjatë viteve 1959-1962, Pici, ushtar-fotograf realizoi fotografitë e para dokumentare ku bënë pjesë edhe Petrit Ristani, Agron Kruti, Kosta Bej, Bujar dhe Alma Duka, të drejtuar fillimisht nga nxënësi i Gegë Marubit të madh, Rrok Berisha. Detyra e tyre ishte dokumentimi i veprimtarisë (stërvitjeve dhe jetës) së reparteve të Ushtrisë Shqiptare të të gjitha llojeve të armëve. Në një farë mënyre prej këtij stafi fotografësh dhe laborantësh, si pjesë e atij që emërtohej Labo-

ratori Qendror Fotografik i Ushtrisë, është i plotë "Ditari Fotografik" i ushtrisë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe Paradat Ushtarake. Ndërsa gjatë viteve 1983-1990, Nikolini ishte koleg, dhe mik njëkohësisht, në të njëjtin laborator fotografik (në Ministrinë e Mbrojtjes) me mjeshterin tjetër të fotografisë Alqi Golloshi, që mbulonte shërbimin fotografik për gazetën "Luftëtari".

Në arkivin e madh të laboratorit emri i Nikolin Picit zë vend të rëndësishëm.

Në vitet 1970-1990 Nikolin Pici ishte fotograf i botimeve të



Ministrisë së Mbrojtjes në Revistën "10 Korriku", por botonte foto dhe në

gazetën "Luftëtari". Fotografitë e tij ishin pjesë e mediave të tjera të kohës, si revista "Ylli", "Shqiptarja e re", "Shqipëria sot" etj.). Nikolin Pici ka qenë prezent me fotografitë e tij në albumet e botuara nga Ministria e Mbrojtjes deri në vitet 1990 dhe më tej në botime të tjera të veçanta për artit ikonografik. Ndër këto botime zënë vend të merituar Albumet: "25 vjet Ushtri Popullore", "Marshon Shqipëria Socialiste", "Ushtria Popullore në artet figurative", botim i Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë, si dhe "Ikona bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri" në vitin 2007 me autor Ylli Drishtin.

Në vitin 1982, Pici çel dhe ekspozitën e tij me 130 vepra fotografike me temë nga ushtria shqiptare. Gjatë viteve 1990-2000, Pici ishte fotografi i Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë, ku ai ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në dokumentimin e veprimtarive artistike të saj, si dhe në botimet që Galeria ka realizuar, si katalog me titull "Ikona Shqiptare" në vitin 2001 me autor Ylli Drishtin, Monografi të "Thoma Thomai", (1997), revista "Pamorart" etj.).

Mjeshtri Nikolin Pici bën pjesë në grupin e fotografit klasik shqiptar i viteve 1960-1990. Ai u formua në studion e babait dhe ruajti traditën e mjeshtrove të fotografisë shqiptare si Marubi, Radovani, Ristani, Jakova, Nënshati, Golloshi, Kallfa, Veseli. Ai

ishite mik dhe koleg me Petrit Kumin, Refik Veselin, Besim Fushën dhe Leon Çikën etj.

Nikolin Pici shërbeu për 31 vite në Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Ministria e Mbrojtjes duhet të jetë krenare me emrin e tij dhe brezave të fotografëve që i shërbyen.

Ilo Frashëri, ishite fotoreporter er për revistën “10 Korriku”, në vitet 1967- 1969



Petrit Ristani (fotograf)

Petrit Ristani është një nga mjeshtrit fotografisë shqiptare. Ai vinte nga një familje e shquar fotografësh, me origjinë nga Zagoria e Gjirokastrës, ku të parët e tyre, Vasili me Janin, kishin emigruar në Stamboll dhe në Argjentinë, ku dhe mësuan zanatin e fotografit. Pasi u kthyen në Shqipëri, u vendosën në Tiranë, ku në vitin 1935 hapën dyqanin e tyre “Foto-studio Ristani” në Bulevardin “Zogu i Parë”. Shumë shpejt u bënë të njohur dhe e ushtruan atë mjeshtri në katër breza, ku me aparatet e tyre, për më shumë se një shekull, kanë fiksuar momente historike nga historia e Shqipërisë. Petrit Ristani, i cili ka trashëguar zanatin e babait dhe të xaxhait të



tij Janit, ka punuar për 30 vjet në organet e shtypit ushtarak, njihet si një nga fotografët më në zë të para viteve '90-të edhe për kontributin e jashtëzakonshëm si fotograf në shërbim të Forcave të Armatosura.

Agron Kruti (fotograf)

Agron Kruti ishte fotoreporter i revistës “10 Korriku” gjatë viteve '70. Ai ishte pjesë e grupit të fotografëve të Laboratorit Fotografik Qendror të Ushtrisë Shqiptare ku



bënin pjesë Petrit Ristani, Kosta Bej, Bujar dhe Alma Duka, ku kishte si detyrë dokumentimin e veprimtarisë (stërvitjeve dhe jetës) së reparteve të Ushtrisë Shqiptare dhe të të gjitha llojeve të armëve. Është fotograf me shumë rëndësi në shtypin ushtarak të viteve '70.

Fatmir Haxhiu (piktor)

Fatmir Haxhiu ka lindur në Gjirokastrë më 28.12.1927-10.03.2001, Tiranë.

Ai njihet si piktor i përmasave të mëdha me tema historike.

Vitet '50 janë shumë të frytshme për të, ku ka punuar për një periudhë të gjatë për shtypin ushtarak. Ai bëhet krijues i studios së parë ushtarake në Shqipëri, ku pasohet dhe nga artistë të tjerë, derisa në vitin 1959 merr pjesë në ekspozitën kombëtare të pikturës, ku vlerësohet me çmimin e dytë. Haxhiu është aktiv me vizatime e grafika në revistën

“10 korriku”, po ashtu krijon shumë ilustrime me emocion dramatik.

Gjatë karrierës së tij të pasur, Haxhiu, është nderuar me shumë çmime të rëndësishme, përfshirë Çmimin e Republikës së shkallës së parë dhe të tretë. Gjithashtu atij iu ndanë titujt e lartë “Piktor i Merituar”, “Mjeshtër i Madh i Punës” dhe “Qytetar Nderi”. Fatmir Haxhiu njihet si piktor që ka trajtuar të gjitha gjinitë, ka trajtuar tema në pikturën monumentale, në atë të kavaletit por dhe për gjinitë e peizazhit, natyrës së qetë e portretit. Puna më e madhe e tij është “Bashkimi i Principatave Shqiptare”. Është një murale e cila ndodhet në pavijonin e mesjetës së Muzeut Historik Kombëtar. Ai njihet si piktor i përmasave të mëdha me tema historike.

Sotir Lito

ishte gjithashtu një nga piktorët më të suksesshëm të revistës “10 Korriku”, gjatë viteve 1970



Kosta Raka (piktor)

Kosta Raka ka lindur më 15 maj të vitit 1953 në Sarandë. Ai është një artist me krijimtari shumë të gjerë. Ka studiuar për instrumentin e violinës, në vitet 1962-1968. Më tej vazhdoi studimet për pikturë kavalete, skulpturë dhe skenografi. Falë talentit të tij do të punonte skenograf i Estradës së Ushtarit gjatë viteve 1972-1975 dhe në qershor të vitit 1975 punoi në Spitalin Ushtarak me detyrën e piktorit skicograf. Ndërsa karikaturën e ka filluar rreth vitit 1979, krejt rastësisht, nisur nga disa rrethana të momentit. Me vullnet dhe dëshirë për karikaturën krijoi lidhje me disa organe shtypi, të cilat shtuan kërkesat ndaj karikaturave të tij. Ky ka qenë dhe momenti kur Kosta tregoi interes për këtë gjini të vështirë, por të bukur të arteve figurative. Për karikaturën çdo gjë i erdhi natyrshëm.

edhe kontributit që vazhdonte të jepte në shtypin e kohës emërohet punonjës pranë Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë, ku punoi si piktor – dekorator. Punët e tij artistike tashmë do t'i shërbenin trupave artistike të ushtrisë: Ansambli Artistik, Estradës së Ushtarit, si dhe Orkestrës Frymore të Ushtrisë. Më 1979 bëri karikaturat e para dhe në vitin 1980 fitoi çmimin e parë në këtë gjini të re. Më tej u shpall nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, për tre vjet rresht, karikaturisti më i mirë i vitit. Ai vazhdoi punën e tij si piktor në revistën “Mbrotjtja” në vitet 1995-2000.

Alqi Golloshi

Alqi Golloshi është nga fotografë me traditë familjare siç janë: Marubi, Kallfa, Pici, Ristani, Veseli etj. Alqi fillimet e tij në njohjen e botës së fotografisë i pati që fëmijë në laboratorin e të atit. Puna e vërtetë si fotograf për Golloshin fillon në shtypin ushtarak, në Ministrinë e Mbrotjtjes (1982-1992), duke qenë kolegu më i ri i mjeshtrit Nikolin Pici). Në vitin 1986 Golloshi paraqitet para publikut të kryeqytetit me ekspozitën e parë vetjake në Pallatin e Kulturës Tiranë dhe në vitin 1991 çeli, në Muzeun Historik Kombëtar, ekspozitën “Ringjallja e fesë në Shqipëri”.



Kastriot Kofina,

ka punuar si
fotoreporter për
revistën
"Mbrotjtja" në
vitet 2002-
2008.

Elvin Hasanaj,

fotograf i
revistës
"Mbrotjtja",
2008-2022...





Festimet e Vitit të Ri me fëmijët e prindërve nën uniformën ushtarake

Ministri Peleshi: I lumtur që jam sot mes jush, e ardhmja jonë!



Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u organizuan nga sektori i aktiviteteve, pranë QKMBMMFA, festimet e vitit të ri me fëmijët e prindërve nën uniformën ushtarake. Në këtë aktivitet morën pjesë ministri i mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i shtabit të përgjithshëm gjeneral major Bajram Begaj. Të cilët uruan fëmijët për sa më shumë shëndet dhe suksese, si dhe falënderuan prindërit e tyre për përkushtimin dhe devotshmërinë e treguar në këtë vit të vështirë. Më pas mes këngëve fëmijore u shpërndanë dhurata nga të pranishmit.



REKRUTIMI

Ministria e Mbrojtjes: Fushata e rekrutimit, si duhet të aplikojnë dhe kriteret që duhet të plotësojnë të rinjtë për t'u bërë pjesë e FA-së

Veç trajtimit financiar, çdo i kualifikuar për të vijuar karrierën brenda Forcave të Armatosura do të gëzojë edhe një sërë mundësish

Rekrutimi i ushtarëve me një profil sa më të lartë është thelbësor për Forcat e Armatosura. Ndaj Ministria e Mbrojtjes përcakton si pjesë të kriterëve, që duhet të plotësojnë të gjithë të rinjtë e të rejtat, një profil cilësor, të aftë nga ana fizike dhe shëndetësore dhe me një nivel të lartë kulturor.

Për të filluar procesin e rekrutimit çdo i interesuar duhet të plotësojë edhe një sërë dokumentesh:

Djemtë dhe vajzat nga mosha 18 vjeç deri në 27 vjeç me arsim 9 - vjeçar, të mesëm apo të lartë mund të aplikojnë në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, ku një pjesë e veçantë i është dedikuar rekrutimeve. Procedurat e përzgjedhjes së ushtarëve/detarëve do të jenë transparente dhe të dokumentuara.

Të rinjtë do të kalojnë edhe tre teste; atë fizik, intelektual dhe psikologjik që do të kryhet në faza të caktuara.

Veç trajtimit financiar, çdo i kualifikuar për të vijuar karrierën brenda Forcave të Armatosura do të gëzojë edhe një sërë mundësish:

- të ardhura mujore dinjitoze, si asnjëherë më parë për FA,
- arsimim dhe aftësim profesional në vazhdim, brenda dhe jashtë vendit,
- përgatitje fizike sipas standardeve të NATO-s,
- trajnime dhe stërvitje jashtë vendit së bashku me kolegët e tjerë të NATO dhe SHBA, e të tjera përfitime.



Nga Elbasani nisi procesi i rekrutimit për ushtarë/detarë në Forcat e Armatosura. Pjesë e aktivitetit ishin ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bajram Begaj, kreu i bashkisë së Elbasanit dhe deputetë të qarkut. Gjatë fjalës së tij, ministri Niko Peleshi e cilësoi tejet të rëndësishme këtë fushatë. "Ne, sot i shikojmë në sy të gjithë të rinjtë dhe të rejtat të cilëve iu drejtojmë ftesën për t'u bërë pjesë e FA, sepse kemi arritur t'i japim një drejtim dinjitoz duke filluar nga paga. Siç e dini kemi një rritje prej 30%, një rritje të sheshtë, që do të thotë rritje nga ushtari i parë tek gjenerali; një rritje 30% të pagës që do të thotë: ai që sot rekrutohet në ushtri merr një



Nga Elbasani nis rekrutimi për ushtarë/detarë

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Ne, sot i shikojmë në sy të gjithë të rinjtë dhe të rejat të cilëve iu drejtojmë ftesën për t'u bërë pjesë e FA-së

“Kemi arritur t'i japim një drejtim dinjitoz dhe një pagë të niveleve si ajo e aleatëve tanë”

pagë më shumë se 50 mijë lekë të reja që në momentin e parë por nuk është vetëm kjo: së pari të jesh kontributor në FA do të

thotë që të bësh pjesë në atë fashë të qytetarëve shqiptarë, të cilët janë sot për sot më të kuotuarit në opinionin pub-

lik sipas të gjitha sondazheve, pyetësorëve, institucioni ku qytetarët besojnë më tepër janë FA”, -theksoi ministri Peleshi.

Më tej në fjalën e tij ai shtoi se FA-të kanë një prezantim dinjitoz në misionet e NATO-s prej më shumë se 20 vitesh në zona si Afganistani, Iraku, Kosova, Bosnja, Afrika apo Letonia.

FA me të vërtetë është krenari dhe ne sot përmes këtij eventi që po fillojmë në Elbasan dhe do të shkojmë në të gjithë Shqipërinë, duam ta sjellim më pranë publikut atë çka janë FA-të, mundësitë që ofrojnë dhe mbi të gjitha krenarinë dhe nderin që të shërbesh në të”, -tha ministri i Mbrojtjes.

Duke ftuar djemtë dhe vajzat të bëhen pjesë e FA-së përmes këtij procesi rekrutimi, ministri Peleshi tha se ata kanë mundësi të ngrihen në karrierë dhe të përfitojnë nga trajnimet brenda dhe jashtë vendit. “Djem, vajza dhe ushtarakë, të cilët në varësi të shkollimit të tyre dhe të dëshirës për të ecur në karrierë, nuk bëhet fjalë vetëm për të filluar dhe shërbyer deri në fund të jetës së tyre profesionale si ushtar bazë, por kanë mundësi të ngrihen si Ushtar i Parë, Ushtar i Dytë, Ushtar i Tretë, Ushtar i Katërt dhe pastaj, nëse kanë një shkollë të mesme, është linja tjetër e karrierës, apo ata që kanë një shkollë të lartë duan të përfitojnë nga kurset e oficerit, kurse të shumta brenda vendit jashtë vendit, SHBA apo vende të tjera aleate të NATO-s kanë mundësinë që të arrijnë pse jo edhe në gradat më të larta të vendit. Sot për sot, do të thosha, sistemi ka shpërblimin më dinjitoz edhe në terma page, por edhe në terma morale”, -tha z. Peleshi. Fushata e rekrutimit ka nisur edhe në Tiranë dhe do të vijojë deri më 20 janar 2022. Rreth 400 vende të lira janë sot pranë FA-së për ushtarë dhe detarë aktivë. Procesi është i hapur për të gjithë të rinjtë apo të rejat nga 18 deri në 27 vjeç me arsim 9-vjeçar, të mesëm apo të lartë.



Rreziku nga sulmet kibernetike

Peleshi: Qeveria do të subvencionojë studimet në këtë fushë, bonuse për specialistët e mbrojtjes kibernetike në shtet

Ministri i Mbrojtjes: Krahas bachelorit në sistemin e arsimit privat apo shtetëror do të shtojmë një program të posaçëm qeveritar, edukimin dhe trajnimin e shpejtë në fushat ku rreziku nga sulmet kibernetike është i madh: kodim, programim, mbrojtje

Siguria kibernetike po bëhet çdo ditë e më shumë një fushë që kërkon fuqi punëtore të specializuar, ndaj ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, si drejtues i institucionit që shumë shpejt do të marrë drejtimin për garantimin e mbrojtjes kibernetike, përshëndeti pjesëmarrësit në aktivitetin inovativ "Cyber Camp Albania", ku ftoi të rinjtë të orientojnë karrierën e tyre drejt kësaj fushe.

Ministri Peleshi vuri në dukje rrezikun që u kanoset shpesh institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore nga sulmet kibernetike, jo vetëm në

Shqipëri, por në SHBA, ku, siç thahet, në çdo 39 sekonda ka një sulm të tillë. Shembuj ka edhe për ndërhyrjen përmes këtyre sulmeve në procese elektorale, apo në infrastrukturën kritike të shteteve.

Duke sjellë edhe përvojën e Izraelit, ku ministri Peleshi ishte për vizitë zyrtare pak ditë më parë u shpreh: "Kjo do të thotë që ka nevojë për talente, ka nevojë për fuqi punëtore, për njerëz të kualifikuar. Sot në botë ka miliona vende pune bosh në fushën e zhvillimit të software-ve dhe aq më tepër në fushën e Mbrojtjes Kibernetike. Unë isha para disa ditësh në Izrael e, vetëm në Tel Aviv



kishte 17 mijë vende pune, të cilat nuk mbusheshin dot, sepse nuk i gjenin dot në treg. Janë miliona vende pune në botë, të cilat presin talente dhe për këtë arsye këto fusha janë nga fushat më të paguara, profesionet më të paguara”. Sipas z. Peleshi, Ministria e Mbrojtjes

e infrastrukturës kritike që domosdoshmërisht duhet të kenë të zhvilluara kapacitetet e mbrojtjes kibernetike. Ai tha se gjithçka fillon nga edukimi dhe sot janë 16 studentë që fillojnë Masterin e Mbrojtjes Kibernetike pranë Akademisë së FA-së, ndërsa po punohet për

të posaçëm qeveritar edukimin dhe trajnimin e shpejtë në fushat për të cilat po flasim pra: kodim, programim, mbrojtje kibernetike. Mundësitë janë të jashtëzakonshme. Ne kemi një fond për mbështetjen e njëmijë apo dymijë koduesve, ose të rinjve, që duan të kualifikohen dhe të bëhen kodues, apo të punojnë në të gjitha fushat e IT, këto si subvencion, pra për të paguar bursat e tyre. Kemi disa kompani shumë të mira që janë në kontakt me qeverinë dhe do të jenë aplikues të këtij fondi”, - u shpreh ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se kryeministri ka dhënë dritën jeshile për të shtuar pagesën me bonuse për specialistët e kësaj fushe në administratën shtetërore, duke i barazuar këto paga me tregun privat.

Aktiviteti inovativ “Cyber Camp Albania” është konceptuar si një aktivitet vjetor, i cili do të organizohet me dy edicione (dhjetor dhe maj) të çdo viti akademik, për të theksuar rëndësinë e edukimit dhe orientimit drejt profileve të sigurisë



do të punojë bashkë me Agjencinë e Certifikimit Elektronik të Mbrojtjes Kibernetike për të bërë politikat e mbrojtjes kibernetike, standardet, rregullat e zbatueshme nga të gjitha ato institucione të cilat janë pjesë

të shtuar mundësitë e kualifikimeve, trajnimeve në këtë fushë.

“Kështu që krahas bachelorit në sistemin e arsimit privat, apo shtetëror do të shtojmë dhe do të mbështesim, do të subvencionojmë me një program

kibernetike të të rinjve në fazat e hershme të studimit në njëri anë dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë në fushën e sigurisë kibernetike dhe krimit kibernetik në nivel kombëtar në anën tjetër.

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Defender Europe-21 ishte shembulli më i mirë i këtij bashkëpunimi

Shqipëria,
vend pritës
për stërvitjen
Resolute
Castle për
vitin 2022 dhe
pjesë e Stërvitjeve
Defender
Europe 23/25

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën Amerikane në Evropë (USEUCOM) dhe atë të Ushtrisë Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR), në Shtutgard dhe Viesbaden, Gjermani. Pjesë e delegacionit ishte edhe ambasadorja amerikane në Tiranë Juri Kim, atasheu ushtarak i Mbrojtjes së SHBA-së, kapiten i Rangut të II-të David Millner, Shefi i zyrës Amerikane Bashkëpunimit të mbrojtjes N/Kolonel Erol Munir.

Gjeneralmajor Begaj u prit në takim nga komandanti i USAREUR gjeneral Christopher G. Cavoli si dhe zëvendëskomandanti i EUCOM gjenerallejtënant Michael L. Howard. Në fjalën e rastit gjeneralmajor Begaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak që ekziston midis Shqipërisë dhe SHBA-së, duke vlerësuar kontributin e vazhdueshëm që ushtria amerikane ka dhënë dhe vazhdon të japë në rritjen e aftësive operacionale të FARSH. Nga ana e tyre, gjeneral Cavoli dhe gjenerallejtënant Howard vlerësuan maksimalisht angazhimin dhe performancën e treguar nga FARSH në të gjitha kontributet ndër vite, si pjesë e misioneve dhe operacioneve të ndryshme, qoftë kjo pjesë e NATO-s apo edhe ato me SHBA.

Gjatë bashkëbisedimit me të dy autoritetet, gjeneralmajor Begaj shprehu gatishmërinë dhe rëndësinë për vazhdimin e këtij bashkëpunimi, tashmë të konsoliduar dhe të suksesshëm. Veçanërisht vlerësoi mbështetjen që Departamenti i Mbrojtjes

të SHBA-së planifikon të japë me këshilltarë nga Brigada e Ndhmës së Forcave të Sigurisë për trajnimin, këshillimin, dhe ndihmesën për b2k të FT-së, njësi e cila është planifikuar t'i nënshtrohet vlerësimit të aftësive të NATO-s për vitin 2022. Përveç asistencës teknike, u vlerësua edhe kontributi me pajisje moderne dhe bashkëkohore për këtë batalion, por edhe për njësitë e tjera të FARSH, si regjimenti i helikopterëve me helikopterët Black Hawk, repartet EOD, Qendra e Mbrojtjes Cyber, etj. Shqipëria dëshiron gjithashtu të ofrojë përdorimin e infrastrukturës ushtarake për stërvitje e trajnime të ndryshme për aleatin strategjik SHBA si dhe NATO. Defender Europe - 21 ishte shembulli më i mirë i këtij bashkëpunimi dhe Shqipëria do të jetë vend pritës për stërvitjen Resolute Castle për vitin 2022 dhe pjesë e Stërvitjeve Defender Europe 23/25. Më tej, gjeneralmajor Begaj shprehu një falënderim të veçantë edhe për Zyrën e Bashkëpunimit të SHBA-së në fushën e Mbrojtjes të atashuar në Shqipëri, për punën e vazhdueshme që kjo strukturë vazhdon të japë në këtë drejtim.

Gjatë vizitës, gjeneralmajor Begaj zhvilloi takime edhe me drejtorët e Zbulimit, Planifikimit, Stërvitjeve dhe Operacioneve, si dhe atë të Partneritetit. Për këtë të fundit, nga SHSHP të FA-së u akordua certifikata e mirënjohjes me motivacionin "Për mbështetjen e vazhdueshme dhe të gjithanshme ndaj Shqipërisë, duke rritur ndjeshëm aftësitë e FARSH në fushat e EOD dhe menaxhimit të municioneve (PSSM), si dhe projektet e Ndhmës Humanitare ndaj popullsisë". USEUCOM realizon një gamë të gjerë operacionesh, në koordinim me aleatët dhe partnerët për të mbështetur NATO-n, për të penguar Rusinë, për të mundësuar operacione globale si dhe për t'iu kundërvënë kërcënimeve ndërkombëtare. Ndërkohë, USAREUR siguron forca tokësore të gatshme për të penguar, dhe nëse është e nevojshme, për të mposhtur çdo agresion nga kundërshtar të mundshëm në Evropë dhe Afrikë. Për ta arritur këtë, USAREUR është e përgatitur të shërbejë si shtab i Forcave të Përbashkëta, për të luftuar në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve ushtarake, nga reagimi ndaj emergjencave apo krizave, dhe deri në luftime në shkallë të gjerë.





Portali “e-Albania”, përfitimet e platformës dixhitale për ushtarakët

“E-Albania”, portali që iu shërben të gjithëve, civilë dhe ushtarakë

Përfitimet e platformës dixhitale për ushtarakët

Në Qendrën e Arsimit të Profesionistëve të Nënoficerëve u mbajt një brifing njohës mbi funksionimin e Platformës dixhitale e-Albania. Brifingu njohës u mbajt nga Toger Sonila Zhupani, në të cilin u fol mbi shërbimet që ofron e-Albania, benefitet që kemi ne nga shërbimet e ofruara nga kjo platformë e qeverisë dhe mënyrën sesi mund të aksesojmë për përdorimin e kësaj platforme, për të gjitha nivelet e shërbimit përkatës që ofron. Website e-Albania është kanali kryesor i marrjes së shërbimeve të administratës publike online për qytetarët, bizneset dhe vetë punonjësit e administratës publike, civilë dhe ushtarakë.

Për platformën dixhitale, në fjalën e tij të mbajtur për shtyp, ka folur dhe Kryeministri Rama, ku është shprehur se platforma ofron shërbime të shumta për qytetarët, duke reduktuar kohën e marrjes së shërbimit, duke evituar burokracitë, si dhe duke ulur korrupsionin.

Platforma dixhitale qeveritare e-Albania është tepër e domosdoshme për të gjithë ne, për shërbime të cilat mund t'i marrim përmes saj, lehtësisht dhe pa pasur nevojë të jemi fizikisht nëpërzat e administratave ku ofrohen këto shërbime, duke ndikuar kështu në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve.

E-Albania ofron shërbime publike në çdo orë dhe në çdo kohë, duke ofruar shërbime elektronike të nivelit të parë dhe të dytë, ku çdo i interesuar të marrë informacion të detajuar në lidhje me shërbimet për publikun. Gjithashtu ajo ofron shërbime elektronike të nivelit të tretë dhe të katërt nëpërmjet standardeve më të fundit të teknologjisë, si dhe mundësi për kryerjen e pagesave online për këto shërbime nëpërmjet kartave të debitit dhe kreditit.

Për ushtarakët, portali e-Albania ofron shërbime të shumta si: dëshmi penaliteti, vërtetim përmbartimi, aplikim për statusin e ushtarakut, vërtetim për periudhë pune në ndërmarrje shtetërore, pension shtetëror suple-

mentar, shërbime shtetërore nga statusi dëshmor i atdheut.

Ky portal ofron gërshtetimin e një sërë teknologjive të sigurisë për të mbrojtur të dhënat e përdoruesve. Procesi i regjistrimit kryhet nëpërmjet portalit qeveritar dhe të dhënat e plotësuar, nga përdoruesit gjatë procesit të regjistrimit, verifikohen elektronikisht me të dhënat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile për individët dhe Regjistrimit Kombëtar Tregtar për bizneset.

Platforma dixhitale e qeverisë e-Albania, në ditët e sotme po shndërrohet në kanalin kryesor mbi marrjen e shërbimeve online të administratës publike, ndaj familjarizimi me të është tepër i rëndësishëm.

Në mbyllje të brifingut u mor dhe feedback nga të pranishmit ku u diskutua mbi mundësitë e ofrimit të shërbimeve online nga QAPN (si: listë notash kursantësh, certifikata etj.), përmes platformës qeveritare, e cila ngelet sfida dhe ambicia e së ardhmes së institucionit të QAPN-së.



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Profesionalizmi dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD profesionale dhe specialitet "niche"

Jam besimplotë që personeli i këtij kontingjenti do të mbajë lart e me krenari flamurin kombëtar në Letoni

Në mjediset e Batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit të X-të EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s, si pjesë e grup-batalionit kanadez të dislokuar në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manush-

aqe Shehu e shoqëruar edhe nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, Kolonel Përparim Gega.

Në përshëndetjen e saj drejtuar trupave, gjeneralmajor Shehu pasi adresoi një falënderim të veçantë për të gjithë burrat dhe gratë që shërbejnë në këtë njësi u shpreh ndër të tjera: "Ky është kontingjenti i X-të që shkon në mision në Letoni, nën drejtimin e Komandës së Grup Batalionit Kanadez. Profesionalizmi i treguar, trajnimet me aleatët dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë

strukturën EOD një strukturë të besueshme, profesionale dhe specialitet "niche" siç e quan NATO, për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë e aftë të kryejë detyra shumë të vështira. Jam besimplotë që personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës që i është ngarkuar dhe do të mbajë lart e me krenari flamurin kombëtar në Letoni.", -u shpreh gjeneralmajor Shehu.

Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin e X-të EOD, që nisët në Letoni dhe u mbyll me një foto të përbashkët.

Fjala e zëvendës SHSHP të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu

Jemi krenarë për ju, për shërbimin ndaj vendit dhe Aleancës!

Fjala e zëvendës SHSHP të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, me rastin e nisjes së Kontingjentit të 11-të EOD në Letoni

Të nderuar ushtarakë të kontingjentit të 11-të! Të nderuar kolonel Gega dhe kolonel Gura! Të dashur familjarë!

Më lejoni që në emrin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj dhe në emrin tim si zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm, t'ju përshëndes në këtë ceremoni të përcjelljes së Kontingjentit EOD të Batalionit të Xhenios në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni. Ky është kontingjenti i 11-të që shkon në mision në Letoni nën drejtimin e Komandës të Grup Batalionit Kanadez. Profesionalizmi i treguar, trajnimet me aleatët dhe eksperiencat nga misionet e kaluara, e kanë bërë strukturën EOD një strukturë të besueshme, profesionale dhe specialitet "niche" siç e quan NATO, për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë e aftë të kryejë detyra shumë të vështira.

Shtabi i Përgjithshëm i FA-së dhe Ministria e Mbrojtjes ndjehen krenarë me ju, kur dëgjojmë vlerësimet pozitive nga homologët tanë gjatë takimeve të nivelit të lartë në NATO-s. E njëjta gjë u përcoll edhe nga SHSHP i Kanadasë, gjatë takimit të Komitetit Ushtarak të NATO-s, ku u diskutua me vendet pjesëmarrëse në këtë grup batalion. Unë kam besim që edhe personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës që i është ngarkuar, dhe do të mbajë lart dhe me krenari flamurin kombëtar në Letoni. Prezenca juaj atje nuk është vetëm realizimi i detyrave ushtarake, por

ju jeni promovues të paqes dhe një mesazh i qartë ndaj kundërshtarëve të NATO-s për gatishmërinë e Shqipërisë për përmeshjen e Nenit 5-të NATO-s. Ndaj, imazhi juaj, realizimi i detyrave që nga ato rutinë dhe operacionale, kërkojnë një vëmendje të shtuar, gatishmëri të lartë dhe profesionalizëm.

Gjithashtu, ju këshilloj të ndiqen me korrektesë procedurat standarde të veprimit dhe masat e sigurimit teknik në operacion për të shmangur ngjarjet e jashtëzakonshme dhe eliminimin e humbjes së jetës në operacione të tilla me rrezikshmëri të madhe jete. Gjej rastin sot të falënderoj edhe personelin e batalionit të xhenios, për përgatitjen dhe krijimin e kushteve për stërvitje si ato me të cilët do të përballlet në Mision dhe zhvillimin me përgjegjësi të stërvitjes së këtij kontingjenti.

Njësitë, repartet dhe trupa e xhenierëve janë dalluar ndër vite për punën e tyre të palodhur, të vështirë dhe me një rrezikshmëri të lartë. Kontributi juaj shtrihet jo vetëm në projektet në ndihmë të komunitetit nëpërmjet ndërtimit të urave, rrugëve, por deri tek kontrolli dhe pastrimi i territorit nga municione të periudhave të ndryshme e shkatërrimi i municioneve të tepërta të ushtrisë. Gjej rastin të falënderoj të gjithë burrat dhe gratë që kanë shërbyer në këto njësi dhe shpreh respekt pafund për ata dëshmorë të këtij batalioni, të cilët kanë rënë në krye të detyrës në misionin e paqes në Letoni, siç është rasti i major Klodian Tanushit dhe nëntetares Zarife Hasanaj, të cilët mbeten nderi dhe krenaria juaj dhe e gjithë Forcave të Armatosura. Në këtë rast, dëshiroj të përshëndes dhe të përgëzoj të gjithë ushtarakët që nisen me mision, duke i garantuar ata dhe familjarët e tyre se do të kenë në çdo çast mbështetjen dhe përkujdesjen e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes, për të arritur rezultatet më të mira në përmeshjen e misionit të tyre.

Së fundmi, ju po niseni pak përpara ndërrimit të viteve dhe besoj familjarët tuaj do ta ndiejnë mungesën tuaj gjatë festimeve të Vitit të Ri, por ata edhe në jemi krenarë për ju, për shërbimin ndaj vendit dhe Aleancës. Ndaj ju uroj Gëzuar Festat e Fundvitit dhe shëndet e suksese për vitin e ri 2022.

Ju faleminderit!





Morali, shoqëria, individi

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve

Njeriu është një kafshë sociale. Ai ka një shtytje të natyrshme për të jetuar një jetë të lidhur me të tjerët. Duke jetuar me të tjerët ai i gëzon frytet e përbashkëta të jetës. Njeriu ka nevojë për shoqërinë për ekzistencën e tij. Fëmija varet nga prindërit e tij. Kapacitetet e natyrshme të fëmijës mund të zhvillohen vetëm në shoqëri. E gjithë kjo dëshmon se njeriu është nga natyra dhe domosdoshmëria një kafshë sociale. Ai është i lidhur ngushtë me jetën shoqërore. Marrëdhënia mes shoqërisë dhe individit është reciproke dhe plotësuese. Shoqëria është e përbërë nga individë dhe çdo individ është një pjesë e pandarë e tërë shoqërore. Individi mund të jetë egoist.

Shoqëria ka kuptim tek individi vetëm për shkak se ajo mbështet dhe kontribuon në qëllimet e vetë individëve. Ajo është një unitet. Kjo ndihmon në zhvillimin e individualitetit të individit, që shoqëria të arrijë qëllimin

e saj që ajo meriton në ditët e sotme. Shoqëria është rezultat i një marrëveshjeje nga njerëz të cilët fillimisht kanë jetuar në një shtet para-social, për shkak se shoqëria është bërë nga njeriu që ajo është më reale se krijimi i tij. Shoqëria është grumbullimi i thjeshtë i individëve. Ashtu si pjesët e një organi të cilat janë




funk-sionalisht të lidhura dhe asnjëra nuk mund të ekzistojë e izoluar nga pjesa tjetër. Pra, anëtarët e një organi social janë të lidhura funksional-

isht me njëri-tjetrin dhe për shoqërinë në tërësi. Prandaj, shoqëria është më reale se sa individuale dhe është më e madhe se shuma e anëtarëve të tij individualë.

Morali është një kategori kulturore shumë e domosdoshme për zhvillimin normal: të një individi, të një familjeje dhe të një shoqërie. Një individ, një familje, një shoqëri dhe një shtet që kanë mungesë morali, apo moral të dyfishtë (moral të rremë), janë në krizë kulmore për t'u shkatërruar. Morali i dyfishtë (morali i rremë) i një individi shpejt mund të bëhet edhe moral i familjes, i shoqërisë dhe i shtetit (Populli thotë me të drejtë: "Bari i keq rritet shpejt").

Jeta shoqërore, ashtu si natyra, ka ligjet e veta. Përcaktuese janë ligjësitë e përgjithshme, marrëdhëniet në prodhim dhe kushtet materiale. Njeriu është produkt i shoqërisë dhe i rrethanave. "Çdo shoqëri, -thotë Sokrati, -e krijon modelin e njeriut sipas vetes së saj". Shoqëria që lamë pas krijoi modelin e njeriut, në kushte e rrethana historike, me ndjesi e identitet të shtuar kombëtar. Është shoqëria, janë marrëdhëniet



shoqëror i pronësisë dhe shpirtëror, territori dhe ndërgjegjja kombëtare, gjuha dhe traditat, idetë dhe botëkuptimi se sa mentaliteti i një individit, i cili mbart në vetvete dhe prirje egoiste, individualiste, që po të shumohen shkojnë në dëm të jetës publike e të shoqërisë në tërësi. Në këtë raport përcaktuese mbeten marrëdhëniet në prodhim dhe karakteri i pronësisë.

Individualizmi është një qëndrim moral dhe filozofik që bazohet mbi idenë se individët duhet të jenë të lirë të përcaktojnë qëllimet e veta dhe brenda kufijve, të veprojnë për t'i arritur këto qëllime, pa u shtrënguar që të sillen sipas dëshirës së individëve të tjerë apo sipas të supozuarës "e mirë e përbashkët". Familja është e shenjtë, në kuptimin më të mirë të fjalës. Ajo është e shenjtë se krijon trashëgiminë gjinore. Të jep dashurinë e fëmijëve, rrit solidaritetin shoqëror, dashurinë ndaj prindërve, miqve e ndaj njëri-tjetrit. Fëmijët lumturohen e gëzohen me dashurinë e prindërve të tyre. Në familje merret edukata e parë.

"Edukata e mirë, është lulja e jetës". Mikpritja dhe bujaria, janë nga cilësitë më të mira që ka krijuar dhe edukuar familja shqiptare. Nga këto nocione, "liria" në kuptimin e lirisë themelore, është më e hershme. Ajo pothuajse ka lindur bashkë me njeriun. Liria ka në themel barazinë e kushteve materiale, të drejtën bazike për të jetuar, për të pasur një shtëpi dhe për t'u arsimituar. Nuk ka liri abstrakte. "Barazia, -thotë Zajme, -është guri i provës së drejtësisë dhe së bashku krijojnë lirinë". Liria është domosdoshmëri jetësore, por ajo nuk është e pakufizuar, veçanërisht kur flitet për liri individuale. "Liria pa kufi, -thotë shkriktari i madh francez Albert Kamy, -është e kundërta e lirisë". "Masa të jetë kurdoherë, -thotë Horaci, -gjithçka ka një kufi".

Bota në të cilën jetojmë, shoqëria njerëzore e së cilës jemi pjesë, gjatë gjithë kohës së ekzistencës së saj ka krijuar rregullatorët e vet për të mbijetuar. Pjesë e këtyre rregullatorëve janë kodet ligjore dhe ato morale, deri diku edhe feja. Këto kode të shkruara dhe të pashkruara bëjnë të mundur jetesën në mënyrë harmonike të njerëzve.

Por çfarë do të ndodhte nëse këtë shoqëri ne do ta linim në liri të plotë, pa ligje, fe apo moral? A do të vazhdonte qenia njerëzore të ekzistonte, a do të kishim zhvillimin dhe lirinë që kemi sot, apo bota do të sundohej nga kaosi?

Mos ndoshta kjo na bën të ndryshëm nga format e tjera të gjallesave? Nëse po, le të jemi ne qeniet humane që me gjuhën e pashkruar të moralit njerëzor të respektojmë lirinë tonë pa cenuar integritetin e tjetrit.

ekonomiko-shoqërore që përcaktojnë shkallën kulturore e të sjelljes së individit. Një shoqëri e përparuar dhe e moralshme, krijon individë të kulturuar e të sjellshëm. Natyrisht, raporti shoqëri-individ është reciprok. Por, në këtë reciprocitet, përcaktuese është shoqëria, janë marrëdhëniet që krijon, në kohë e në hapësirë sipas ligjësisë së përgjithshme të zhvillimit shoqëror dhe të ligjeve e të normave juridike. Në themel të këtij raporti ngrihen interesat shoqërore. Në këtë raport, parësor, primar është interesi i përgjithshëm, që është bazë e jetës së shoqërisë dhe e çdo individit në veçanti. Vetëm nëpërmjet interesit të përgjithshëm, mund të plotësohen interesat personale dhe prirjet e veçanta të individit. Shoqëria dhe individit nuk janë fenomene të ndara. "Në thelb, -thotë V. Gëte, -jemi qenie kolektive". Më shumë, njerëzit i bashkon karakteri



“PARANDALIMI DHE MBROJTJA NË SHEKULLIN XXI”

Demokracia dhe liria janë nën presion

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s nënvizon nevojën për parandalim dhe mbrojtje të fortë

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Në një epokë të konkurrencës strategjike, kur rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla është nën presion, aleatët e NATO-s kanë nevojë për parandalim dhe mbrojtje të fortë për të ruajtur shoqëritë tona të lira dhe të hapura”, -tha Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, më 13 dhjetor 2021, në një seminar mbi të ardhmen e Aleancës së NATO-s. Seminari u organizua nga Mbretëria e Bashkuar, Polonia dhe Portugalia dhe u mbajt në Belgjikë, Bruksel.

“Për të mbajtur njerëzit tanë të sigurt në botën e sotme të paparsikueshme, ne duhet të vazhdojmë të forcojmë dhe modernizojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë. Për ta bërë këtë, tre gjëra janë kyçe: forca të forta dhe të afta; shoqëri të fuqishme dhe elastike; dhe perspektiva globale.”, -tha Sekretari i Përgjithshëm.

Ky seminar është i pari nga katër seminarët mbi zhvillimin e Konceptit të ardhshëm Strategjik të NATO-s. Secili seminar mbledh së bashku udhëheqjen civile dhe ushtarake të NATO-s me zyrtarë nga kryeqytetet aleate, grupe kërkimore dhe akademi. Këto seminare do të informojnë zhvillimin e Konceptit të ardhshëm Strategjik të NATO-s që do të miratohet në Samitin e Madridit vitin e ardhshëm.

Koncepti Strategjik i NATO-s është çelësi i suksesit

Seminari i parë i Konceptit Strat-



egjik, “Parandalimi dhe Mbrojtja në shekullin XXI”, u organizua nga Mbretëria e Bashkuar, ministri i Shtetit James Cleverly dhe bashkëorganizatorët, ministri Mariusz Błaszczak nga Polonia dhe Sekretari i Shtetit Francisco André nga Portugalia. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, duke vlerësuar organizimin dhe duke iu shprehur mirënjohje të gjithëve tha se: “I dyti

pas Traktatit të Uashingtonit, Koncepti Strategjik i NATO-s, është çelësi i suksesit tonë. Ai përcakton një vizion të përbashkët të kërcënimeve, sfidave dhe mundësive me të cilat përballemi. Na ndihmon të japim prioritetet dhe të hartojmë përshtatjen tonë të ardhshme si Aleancë”. “Koncepti Strategjik i vitit 2010 na ka shërbyer mirë”, -tha ai, “por kohët ndryshojnë”,

dhe solli shembullin ku koncepti aktual Strategjik i NATO-s thotë se "zona Euro-Atlantike është në paqe". "Por sot ne nuk mund ta marrim paqen si të mirëqenë", -tha ai dhe nënvizoi se: "Jetojmë në një epokë të konkurrencës sistematike, ku demokracia dhe liria janë nën presion sepse regjimet autoritare po e shtyjnë rendin e bazuar në rregulla ndërkombëtare, duke promovuar modele alternative të qeverisjes dhe duke përdorur propagandën dhe dezinformimin për të minuar shoqëritë tona dhe mjete keqdashëse kibernetike për të ndërhyrë në zgjedhjet tona. Për t'i mbajtur njerëzit tanë të sigurt, në botën e sotme të paparashikueshme, ne duhet të vazhdojmë të forcojmë dhe modernizojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë dhe për ta bërë këtë tre gjëra janë thelbësore: "Forca të forta, të afta; Shoqëri të forta, elastike; dhe perspektiva globale."

Së pari, një ushtri e aftë dhe efektive

"Gatishmëria ushtarake ka qenë gjithmonë thelbësore për misionin e NATO-s dhe gjithmonë do të jetë. Aktualisht kemi grupe luftarake në vendet baltike dhe Poloni dhe 40,000 trupa në Forcën e zgjeruar të Reagimit të NATO-s. Ne duhet të ndërtojmë mbi këtë progres", -tha Jens Stoltenberg. "Rritje e shpenzimeve për mbrojtjen, investim në pajisje të mëdha dhe teknologji të reja dhe të sigurohemi që kemi forcat e duhura, me aftësitë e duhura, në vendin e duhur, në kohën e duhur", -tha ai. "Ne duhet të vazhdojmë të investojmë në aftësitë për të penguar dhe mbrojtur veten në tokë, në ajër dhe në det por gjithashtu duhet të jemi në gjendje ta bëjmë këtë në hapësirën kibernetike dhe në hapësirën e jashtme. Koncepti i ardhshëm strategjik duhet gjithashtu të riafirmojë rolin qendror të parandalimit tonë bërthamor dhe marrëveshjet tona për ndarjen bërthamore. Armët bërthamore që ne ndajmë në NATO u ofrojnë aleatëve europianë një

ombrellë efektive bërthamore dhe ato janë një sinjal i rëndësishëm i unitetit aleat kundër çdo kundërshtari të armatosur bërthamor. Qëllimi afatgjatë i NATO-s është një botë pa armë bërthamore, por për sa kohë që ekzistojnë armët bërthamore, NATO do të mbetet një Aleancë bërthamore. Koncepti i ri duhet të theksojë gjithashtu angazhimin afatgjatë të NATO-s për kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen. Kjo është jetike për parandalimin dhe mbrojtjen tonë. dhe kështu duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.", -u shpreh Stoltenberg.

Së dyti, frenim dhe mbrojtje të fortë dhe shoqëri të forta

Për të pasur një frenim dhe mbrojtje të fortë na duhen shoqëri të forta. Përçarja shoqërore mund të jetë e shpejtë dhe e lehtë. Duhet vetëm një klikim i një butoni për të mbyllur rrjetet tona. Një postim në Twitter për të përhapur dezinformata te qytetarët tanë dhe një pandemi për të paralizuar ekonominë tona. Konkurrentët tanë ose kundërshtarët e mundshëm po shfrytëzojnë varësinë tonë dixhitale. Ata po investojnë shumë në infrastrukturën tonë kritike, nga portet dhe aeroportet në termocentralet dhe rrjetet 5G, si një mënyrë për të ndërhyrë në shoqëritë tona dhe për të minuar sigurinë tonë. Ata po përdorin mbështetjen tonë në furnizimet thelbësore", -tha Jens Stoltenberg. Ai theksoi se: "Për t'i bërë shoqëritë tona më të forta, infrastruktura jonë duhet të jetë më elastike, zinxhirët tanë të furnizimit më të larmishëm dhe të sigurt dhe njerëzit tanë dhe institucionet tona më të afta për të rezistuar dhe për t'u rikthyer nga sulmet. Ne duhet të përdorim NATO-n për të koordinuar më mirë përgjigjet ushtarake dhe joushtarake ndaj sulmeve hibride dhe të mblidhemi për të vlerësuar, atribuar dhe vepruar shpejt. Nevoja për qëndrueshmëri kombëtare i ka

rrënjët në nenin 3 të Traktatit të Uashingtonit. Të gjithë aleatët kanë një rol për të luajtur, ashtu si NATO, prandaj "për të ndërtuar shoqëri të forta, është veçanërisht e rëndësishme që NATO dhe BE të punojnë ngushtë së bashku, duke u mbështetur në pikat e forta përkatëse".

Ndërgjegjësim dhe shtrirje globale

"Së fundi, gjëja e tretë që na duhet të ruajmë një parandalim dhe mbrojtje efektive, është një ndërgjegjësim dhe shtrirje globale. NATO është një aleancë e Europës dhe Amerikës së Veriut, por rajoni ynë përballet me sfida globale. Shumë nga kërcënimet e sotme, nga sulmet kibernetike dhe avionët hipersonikë, ndaj terrorizmit ndërkombëtar dhe ndryshimeve klimatike, nuk kufizohen nga gjeografia apo nga vijat në një hartë dhe sigurisht, ngritja e Kinës ka gjithashtu një ndikim të qartë në sigurinë tonë. Pra, në një botë më konkurruese, një qasje globale nuk është thjesht një 'është mirë ta kesh', është gjithashtu një domosdoshmëri absolute. Ne duhet të jemi të përgatitur për t'u mbrojtur kundër të gjitha kërcënimeve dhe të gjitha sfidave. Kjo do të thotë të ruash një shtrirje globale, me aftësinë për të vendosur forcën ushtarake kudo që mund të shfaqen kërcënime ndaj popullit tonë dhe territoreve tona, por nga ana tjetër kjo do të thotë të punosh ngushtë me partnerë me të njëjtin mendim në të gjithë globin dhe në Evropë, duke përfshirë edhe BE-në. Ne duhet të vazhdojmë të forcojmë NATO-n", -tha ai, "sepse kështu ajo mund të përballojë çdo krizë, të pengojë çdo armik dhe t'i rezistojë çdo ndryshimi në erërat politike". "Forca të armatosura më të forta dhe të afta, shoqëri të forta dhe elastike, qasje globale dhe Europa dhe Amerika e Veriut së bashku në NATO, kështu do të frenojmë dhe mbrohemi nga çdo kërcënim në dekadat në vijim.", -përfundoi Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg.



Unëshkrua Plani i Bashkëpunimit Bilateral ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe Shtabit të Mbrojtjes të Italisë.

Në Ministrinë e Mbrojtjes, sot është mbajtur takimi bilateral ndërmjet Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Shtabit të Mbrojtjes së Forcave të Armatosura të Italisë.

Me këtë rast, është nënshkruar Plani Bilateral Vjetor i Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Mbrojtjes të Italisë për vitin 2022, ndërmjet drejtorit të Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Sylejman Caka dhe shefit të Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Shtabit të Mbrojtjes së Italisë, kolonel Luca Vitali.

Të dy delegacionet u pajtuan që të angazhohen maksimalisht për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në planin përkatës. Partneriteti ynë me Republikën e Italisë, si vend anëtar i NATO-s, vlerësohet shumë i rëndësishëm në kuadër të politikave tona për fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes.



Nënshkruhet Plani i Bashkëpunimit Bilateral ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe Shtabit të Mbrojtjes të Italisë



Ministri Mehaj: Populli i Kosovës asnjëherë nuk e harron kontributin e Turqisë në ngritjen e kapaciteteve ushtarake

Me nderime të larta ushtarake, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, priti në vizitë zyrtare ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, Hulusi Akar, me delegacionin e tij.

Fillimisht, ministri Mehaj i shprehu mirëseardhje homologut të tij turk dhe e falënderoi Republikën e Turqisë për kontributin që ka dhënë deri më tani për shtetin e Kosovës.

“Populli i Kosovës asnjëherë nuk e harron kontributin e Turqisë që ka dhënë në ditët tona më të vështira, por gjithashtu e falënderojmë edhe për kontributin e madh që po jep në ngritjen e kapaciteteve ushtarake”, -tha ministri Mehaj. Më tej, të dy ministrat biseduan lidhur me tema të ndryshme sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes jo vetëm në Kosovë por në rajon dhe më gjerë, ku me këtë rast, ministri Mehaj e falënderoi ministrin Akar për kontributin e



kontingjentit të forcave turke në kuadër të KFOR-it, për paqen dhe sigurinë në vend.

Në këtë takim u bisedua edhe për shkëmbim të përvojave në sferën e edukimit, trajnimit të personelit ushtarak, gjithashtu edhe për pjesëmarrje në ushtrime të përbashkëta ushtarake.

Gjithashtu, u bisedua lidhur me mbështetjen e Republikën e Kosovës në integrimin në organizata euroatlantike.

“Përderisa bashkëpunimi në mes të dy vendeve tona po thello-

het çdo ditë e më shumë, shteti i Turqisë po bën përpjekje të mëdha në integrimin e Kosovës në organizatat euroatlantike”, -theksoi ministri turk i Mbrojtjes, Hulusi Akar, duke shtuar se hapat që ka marrë Republika e Kosovës deri më tani në fushën e diplomacisë së mbrojtjes,

janë shumë të rëndësishëm.

Ministri Akar vazhdoi vizitën e tij zyrtare me takimet e planifikuara edhe me Presidenten Osmani-Sadriu dhe Kryeministrin Kurti.

EURODEPUTETËT MIRATOJNË RAPORTIN

Këshilli i BE-së t'i liberalizojë vizat për Kosovën pa vonesa

Komisioni i Punëve të Jashtme i Parlamentit Evropian miratoi raportin për adresimin e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor dhe nevojën që BE-ja të përshpejtojë procesin e integritetit. Në raport deputetët e Parlamentit Evropian kanë kërkuar liberalizim të vizave për Kosovën nga Këshilli i BE-së, pasi sipas tyre izolimi

shton aktivitetet kriminale.

Raporti u miratua me 531 vota pro, 48 kundër dhe 117 abstenime.

Gjithashtu eurodeputetët i bënë thirrje Këshillit që të miratojë liberalizimin e vizave për Kosovën pa vonesa të mëtejshme. Sipas raportit të dalë nga ky komision, “Faktorët kryesorë që i bëjnë shoqëritë

e Ballkanit Perëndimor të ekspozuara, janë mungesa e mundësive të punësimit, korrupsioni, dezinformimi, elementët e kapjes së shtetit, pabarazia dhe ndërhyrja e huaj nga regjimet jodemokratike si Rusia dhe Kina”, thuhet në komunikatën për media të Komisionit për Punë të Jashtme të PE-së.



Ajo me të drejtë cilësohet si legjendë e sportit të xhudos. Ajo me të drejtë konsiderohet heroinë e Kosovës. Me tri dekadat e jetës së saj, Majlinda u bë fytyra e Kosovës së sotme, që e bëri shtetin tonë të tillë çfarë e duam. Flamuri kaltër-verdhë valoi majave krahas flamujve të shteteve më të mëdha anekënd globit, falë triumfit të Majlindës. Ajo na mbajti në ethe, na bëri të qajmë nga gëzimi, na bëri nder e krenari.

Tridhjetë vjeçarja është heroina dhe krenaria e gjithë vendit tonë. Ajo nuk është vetëm xhudiste e njohur botërisht, nuk është vetëm kampione botërore me dy tituj nga kampionatet botërore, nuk është vetëm xhudiste me katër tituj europianë dhe një medalje të artë olimpike, nuk është vetëm fituese në Grand Slam, Grand Prix e Masters.

Ajo në fakt ka sfiduar sportin e xhudos me çdo gjë që mund të fitohet dhe ka fituar çdo gjë që mund të fitohet!

Majlinda është ëndrra jonë e realizuar, është vërtetë heroina jonë!

Kosova për herë të parë u përfaqësua në Lojërat Olimpike Rio 2016 me Majlindën dhe për herë të parë ajo ia solli Kosovës medaljen e parë të artë. Falë përkushtimit të saj flamuri i Republikës së Kosovës valoi për herë të parë në këto lojëra. Ajo është e para që i dha jehonë vendit tonë



Vjosa Osmani: Me përulësi të them, faleminderit Majlindë!

Fjala e Presidentes në aktivitetin e veçantë në nderim të Kampiones tonë, Majlinda Kelmendi

të vogël, shtetit që dominohet nga bashkëmoshatarët e saj të rinj. Kjo forcë e pathyeshme me suksese të njëpasnjëshme ishte dhe do të vazhdojë të mbesë frymëzim për vajzat e Kosovës e përtej Kosovës.

Kjo është Majlinda Kelmendi! Shumë më shumë se sa çmimet që i fitoi.

Pa Majlindën dhe guximin e saj për pushtimin e horizonteve të reja, pa modelin që ajo ua dha të rinjve tanë, sot nuk do ta kishim as Distrian e Norën, e shumë vajza të tjera.

Njeriu më i shpejtë në botë,

Eric Liddle, i cili njihet si "skocezi fluturues", thotë se njësoj ka lavdi si në pluhurin e disfatës ashtu edhe në dafinat e fitores, nëse e ke dhënë më të mirën prej vetes! Majlinda e ka dhënë më të mirën e përtej së mirës, ka shndritur duke e vendosur Kosovën në hartën botërore të xhudos me shpirtin e saj luftarak, disiplinën, përkushtimin e pamasë dhe dashurinë ndaj vendit të saj dhe njerëzve të saj.

Një vajzë e vogël me shpirt të madh tashmë nuk është vetëm histori, ajo është simbol i kurajës, është motiv e shpresë që

ka thyer çdo stereotip, cilado qofshin ato. Triumfi i saj, dëshmoi se nuk ka shtete të vogla që s'mund të ngadhënjejnë në sportin e xhudos, siç nuk ka vajza që s'mund të triumfojnë në këtë sport. Majlinda i bëri që të dyja. Tregoi fuqinë e një vajze, sikurse edhe fuqinë e një shteti, për të cilën gjë do t'i jemi falënderues përherë!

Ëndrrën e nisur që prej moshës 8 vjeçe, kur nisi rrugëtimin në sportin e xhudos, ajo e përbushi me këmbëngulje. E përfaqësoi shtetin denjësisht, ishte stoike, luftoi dhe fitoi.

Ajo nuk u josh nga ofertat e shumta të majme për veshjen e fanellës së ndonjë shtetit tjetër, por vendosi t'i qëndrojë besnikërisht ngjyrave të shtetit të saj, Republikës së Kosovës.

Në timonin e trajnerit Driton Kuka, Majlinda dëshmoi se vajzat e Kosovës mundën dhe atë në një sport, i cili tradicionalisht konsiderohej si i djemve.

Natyrisht, ky, një sukses i jashtëzakonshëm nën udhëheqjen e një trajneri profesional, kërkues dhe vizionar siç është Toni Kuka, por edhe një drejtuesi të Federatës së Xhudos, si Agron Kuka.

Toni është njeriu meritator, i cili ka bërë që ta ngjallë pasionin për xhudo jo vetëm tek Majlinda, por edhe shumë vajzave e djemve të tjerë, duke e shndërruar Kosovën në konkurrentin kryesor të Japonisë, vendit ku ka lindur sporti i xhudos. Prandaj, Toni dhe Agron, faleminderit që na keni mrekulluar si shtet, na keni lartësuar dhe na keni bërë krenar krahas shteteve më të fuqishme në këtë disiplinë sportive.

Por, sikurse edhe në procesin e pavarësisë së vendit, edhe në xhudo Kosova nuk do të mund t'i arrinte sukseset pa mbështetjen e miqve të shumtë brenda dhe jashtë vendit. Njeriu që bëri shumë për xhudo e Kosovës, pas insistimit të Majlindës, por edhe për Majlindën vet, në veçanti është presidenti i Federatës Botërore

të Xhudos, Marius Vizer, ndaj me të drejtë rruga te Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë, me vendim të komunës së Pejës mban emrin e tij në shenjë të respektit të përhershëm për atë çfarë ka bërë për vendin tonë. Zoti Vizer, populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës për mundësinë që ia keni dhënë Majlindës, xhudos dhe shtetit të Kosovës që të shkëlqejë ndërkombëtarisht!

Sot ne jemi këtu për ta hapur një kapitull të ri për Majlindën. Siç la një karrierë të suksesshme në sportin aktiv, Majlinda tash e tutje do ta vazhdojë rrugëtimin e saj në angazhime të tjera në sport, ku besoj fuqishëm sërish ajo do të jetë adresë e patejkalueshme e suksesit.

Asaj i ka hije çfarëdo shpërblimi, sepse ajo e meriton cilindo shpërblim. Asnjëherë ne nuk do të mund t'i dalim hakut për emocionet, për krenarinë për dinjitetin që na e ktheu si shtet. Ajo na trimëroi që si vend i vogël t'i dalim përballë fuqive në sportin e xhudos. Majlinda guxoi për ta bërë ëndrrën e saj dhe të shtetit tonë realitet. Ndaj, si guximtare, këtë kapitull jetësor të saj nuk ka se si ta përmbyllë ndryshe, pos edhe me një dekoratë, e cila e mban edhe emrin e një gruaje tjetër po aq guximtare të cilën do t'ia dorëzoj sot. Sikurse heroina jonë Shotë Galica në beteja me pushkë, Majlinda në beteja sportive mbajti gjallë frymëzimin për breza të tërë, krenarinë tonë kombëtare, mbrojti dinjitetin tonë dhe valëviti lart flamurin e shtetit të Kosovës.

Prandaj, me përvulësi të them, faleminderit Majlindë!

Urdhrin me emrin Shotë Galica, një prej urdhrave më të lart presidencial, i cili u ndahet personave, të cilët kanë avokuar, kanë bërë vepra trimërie e akte guximi dhe në të njëjtën kohë kanë kontribuar edhe në barazinë gjinore sot mbahet në duart e të madhes Majlinda Kelmendi.

TAKIMI

Komandanti i FSK-së, Gjeneralmajor Bashkim Jashari, priti në takim Shafen e Operacioneve Aktuale të NATO-s, znj. Ariella Viehe

Gjatë vizitës së saj zyrtare, shefa e Operacioneve Aktuale të Divizionit Operativ të Shtabit të NATO-s, Ariella Viehe, është pritur në takim nga komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Bashkim Jashari.

Gjatë takimit, znj. Ariella Viehe shoqërohej edhe nga Drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneral brigade Jörg Rüter. Me këtë rast, gjeneral Jashari i uroi mirëseardhje asaj, duke i shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e Ekipit të NALT-së në të gjitha arritjet e dërritishme të FSK-së, duke theksuar se bashkëpunimi i ndërsjellë do të thellohet edhe më shumë.

Gjeneral Jashari e njoftoi znj. Viehe për vizionin e tij për zhvillimin dhe avancimin e FSK-së, nga pozita e Komandantit të ri të FSK-së, duke u fokusuar në arritjen e kapaciteteve dhe kapaciteteve ndërvepruese operacionale me forcat e vendeve anëtare të NATO-s.

Ai gjithashtu shprehu vullnetin e tij që Kosova nga vend konsumues i sigurisë, i mundësohet ofrimi i kontributit në operacione të përbashkëta me vendet anëtare dhe partnere të NATO-s, për çka është dëshmuar dhe po dëshmohet suksesshëm edhe në mbështetjen në operacionin aktual humanitar të NATO-s për evakuimin e refugjatëve afganë.

Gjeneral Jashari po ashtu theksoi se përvoja e tij e gjatë si udhëheqës ushtarak, veçanërisht në detyrën e mëparshme si Inspektor i Përgjithshëm i FSK-së, është shumë e rëndësishme për eliminimin e sfidave dhe rrugën e suksesshme përpara drejt përbushjes së vizionit të qartë dhe objektivave të tij operacionale.

TAKIM ME PUNONJËSIT E MM-SË DHE SHP

Ministrja Shekerinska: Së bashku kemi arritur sukses historik

Ministrja Radmilla Shekerinska, në takimin tradicional me punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Armatës i falënderoi ata për punën e palodhur me rezultate të mëdha, përfshirë anëtarësimin historik në Aleancë dhe procesin e integritimit që përfundoi këtë vit në një kohë rekord.

"Pas dy vitesh të vështira, në të cilat nuk mund të organizonim takime të tilla, sot u inkurajua pak dhe thamë që nëse i organizojmë me të gjitha masat, do të thotë të gjithë ju me maska dhe vetëm unë duke folur pa maskë, menduam se ishte një mënyrë e mirë për të rrumbullakuar jo një, por dy vjet.

Ishin nga njëra anë dy vite shumë të vështira, humbëm njerëz të dashur në institucion, më lejoni të shpreh dhimbjen tonë të përbashkët për jetët e humbura si pasojë e Kovidit si edhe si pasojë e situatave post-Kovid.

Një numër personash kanë dalë në pension, por ne i shohim dhe patëm mundësinë edhe për herë të parë pas shumë kohësh t'i pensionojmë solemnisht.

Nga ana tjetër, pavarësisht dy viteve të vështira, këto janë ndoshta ndër vitet më të suksesshme për mbrojtjen në vendin tonë.

Në një periudhë të shkurtër prej 19-20 muajsh u bëmë anëtarë të NATO-s, përfunduam integrimin ushtarak me NATO-n dhe dua të përfitoj nga rasti për t'ju falënderuar, për punën e madhe që përfundoi sot, të gjithëve që morët pjesë dhe mendoj se këtu nuk shoh asnjë që nuk ka marrë pjesë, – ndërsa disa po përgatiteshin këtu, një grup nga ekipi IPT nga Shtabi i Përgjithshëm, nga Ministria, zëvendësimi im ishin në Kuvend dhe arritën të realizojnë edhe këtë vit një pjesë të kontratës për modernizimin me mjete të blinduara të lehta dhe mund të themi në fund të vitit se kemi realizuar mbi



98 për qind të buxhetit tonë.

Urime për përfundimin final, që tregon se kemi mësuar të vrapojmë si në distanca të gjata ashtu edhe në distanca të shkurtra.

Unë me të vërtetë dua t'ju falënderoj për durimin dhe përpjekjen e madhe që keni bërë në këto dy vjet, sepse asgjë nuk funksionoi siç ishim mësuar. Na u desh të ndryshonim të gjitha rregullat, disa nga ato rregulla rezultuan të suksesshme dhe ndoshta duhet, shpresoj që maskat t'i harrojmë shpejt, e disa nga metodat më efektive të bashkëpunimit, ato mund të na bëhen shprehi.

Thonë se nuk mund të kthesh vetëm tre gjëra në jetë – momentin pasi ka kaluar, fjalën pasi është thënë dhe kohën pasi ka humbur. Nëse mund ta përkufizojmë veten si të suksesshëm në këto dy vite, është se nuk kemi bërë asnjë nga këto gabime. Nuk ia lejuam vetes të humbim momentin as si institucion e as si shtet, momentet që ishin fjalë për fjalë një shans strategjik, historik, nuk humbëm fjalët kot, as brenda shtëpisë, as në publik dhe gjithashtu nuk humbëm kohën kot.

Prandaj edhe kishte rezultate.

Dua të them se praktikisht të gjithë ata që morën pjesë në këto

procese do të mund të thonë se ishin pjesë e asaj pamjeje të madhe të quajtur sukses strategjik. Unë mendoj se nuk mund t'i shpërblejmë të gjithë, por më besoni sa herë që prezantojmë një dekoratë, çmim të caktuar, të gjithë jemi të shkruar diku në atë histori suksesi.

Pra, më lejoni t'u kërkoj falje të gjithë atyre që qëndruan më gjatë në punë, të tillë kishte shumë, për të thënë se planet duhet të vazhdojnë të jenë ambicioze, sepse ne thamë që në momentin e parë që anëtarësimi në NATO nuk është qëllimi ynë, pas të cilit do të qëndrojmë të pushojmë, përkundrazi, integrimi ka treguar që kemi ecur edhe më shpejt, por e uroj atë proces dhe jam e bindur që do të vazhdojë.

Në ministri, jam e bindur se deri në fund të mandatit të kësaj qeverie në RVKE, do të arrijmë të vendosim Ligjin për nëpunësit e mbrojtjes dhe falënderoj grupin që vazhdoi punën, këtu në ditët e festave do të mund të punojmë edhe më shumë së bashku, por le të fillojë procesi, sepse kur të nis procesi nuk ka më kthim.

Sipas informacioneve që mora në Kuvend, Ligji për Shërbim me siguri do të mund të miratohet shpejt, por do të shohim, është përtej fuqive tona.

Bëj apel që proceset që kemi nisur për digjitalizimin e proceseve të caktuara, duke filluar nga pagat, me regjistrat personal, e deri te sistemi i prokurimit publik, që realisht të jenë prioriteti juaj. Ministria, ministrja, sekretari i shtetit, Shtabi i Përgjithshëm, ne të gjithë harxhojmë shumë energji dhe kohë për gjëra që duhet të plotësohen teknikisht për të pasur më shumë kohë për t'u marrë me thelbin, përmbajtjen, cilësinë, dhe nëse këto tre procese përfundojnë me sukses në 6 muajt e ardhshëm, jam e bindur se do të kemi më shumë mençuri dhe më shumë guxim për t'u marrë me shumë probleme që kanë mbetur të pazgjidhura, siç është sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit që është përgjegjësia jonë

Shekerinska: Vetoja bullgare "ia doli" në dobësimin e rolit dhe ndikimit të BE-së në të gjithë rajonin

Ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, znj. Radmilla Shekerinska, sot ka marrë pjesë në takimin e ministrave të Mbrojtjes të bashkëpunimit të Evropës Qendrore, që aktualisht mbahet nën presidencën e Kroacisë.

Duke folur në sesionin kushtuar forcimit të partneritetit dhe bashkëpunimit në rrugën drejt integritetit evropian të Ballkanit Perëndimor, Shekerinska theksoi se Maqedonia e Veriut ka qenë plotësisht dhe sinqerisht e përkushtuar ndaj integritetit euroatlantik gjatë katër viteve të fundit, që edhe më shumë rrit zhgënjimin nga vonimi i fillimit të bisedimeve për anëtarësim në BE.

"Maqedonia e Veriut nuk u ul dhe priti të merrte dhuratë, por vitet e fundit ne kemi punuar për reforma thelbësore, të dhimbshme dhe të vështira, jo vetëm për zgjidhjen e çështjeve dypalëshe me Greqinë dhe Bullgarinë, por edhe për çështjet që janë të rëndësishme për agjendën evropiane, siç janë të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, transparenca, lufta kundër korrupsionit, të drejtat e pakicave. Maqedonia e Veriut ka rezultate të dukshme në të gjitha këto çështje", -tha ministrja. Shekerinska theksoi se Ballkani Perëndimor është çelësi i sigurisë dhe suksesit të Bashkimit Evropian, por gjithashtu se siguria, stabiliteti dhe prosperiteti i Ballkanit Perëndimor varen nga perspektivat integruese evropiane.

"Ky mossa për të ofruar atë që meriton Maqedonia e Veriut kërcënon BE-në në një rajon të rëndësishëm të rrethuar nga anëtarët e Unionit. Kjo është arsyeja pse vetoja bullgare



duket se "ia doli" atje ku ndikimet e tjera në jashtë kanë dështuar, për të zvogëluar fuqinë dhe ndikimin e BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor," -tha Shekerinska.

Takimi, i cili u mbajt përmes videokonferencës, u kryesua nga ministri

kroat i Mbrojtjes Mario Banozhiq, ku morën pjesë ministrat e mbrojtjes të Austrisë, Hungarisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Shqipërisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Serbisë, si dhe zëvendësiministat të Republikës Çeke dhe nga Bosnja dhe Hercegovina.

politike, por edhe në pjesën e inovacionit të PAZHAM, për të vazhduar reformat.

Ministria vazhdon me një buxhet tashmë rekord të lartë – 1.76% të PBB-së dhe kjo është një plus dhe do të mund të rezultojë në të ardhura më të larta dhe shanse më të larta, por ai buxhet do të duhet të njihet dhe shpenzohet dhe ne kemi parë që ndonjëherë është vështirë se si të shpenzoni me cilësi dhe shpejt.

Në këto dy vite jemi bërë më pak të bezdisshëm – Ministria e Mbrojtjes prej vitesh, çdo vit është institucioni më transparent, e reja ishte këtë herë që morëm 100 pikë. Ruajeni këtë sepse buxhetet nuk mund të rriten nëse qytetarët nuk kanë përshtypjen se shpenzohen drejt dhe ndershmërisht.

Përderisa të jemi transparent dhe të tregojmë se këto nuk janë para të shpërdoruara, se nuk keqpërdoren, se këto janë paratë nga të cilat do të fluturojnë helikopterët nesër, ushtria do të ndihmojë, do të ndihmojë në të gjitha situatat, kështu buxheti juaj do të jetë i sigurt.

Në fund Shekerinska uroi një vit të suksesshëm, mbi të gjitha shëndet për të gjithë, një lloj tjetër avancimi në karrierë, disa nuk janë më këtu, shkojnë jashtë vendit, disa qëndrojnë këtu me kompetenca dhe përgjegjësi të shtuara, dhe ekipi do të jetë në stres edhe më të madh për të qenë më të mirë, më të shpejtë dhe më efikas.

Ky ekip nuk ndërtohet realisht as në bazë të asaj se kush në cilin pozicion ndodhet, as në bazë të asaj se kush ka punuar për sa vite. Dje morëm videon

se një nga kolegët tanë më të rinj mori një nder shumë të madh si desk oficer i SHBA-së për të marrë njohjen nga partneri ynë strategjik, edhe pse shpejt ka filluar arsimimin si oficer.

Kjo tregon se vërtet ia vlen të investosh në njerëz dhe se rezultatet shihen shumë shpejt. Por ekipi nuk bazohet nëse atë se dikush është "junior" apo "senior", nëse dikush ka një pagë më të lartë apo më të ulët, bazohet vetëm në atë se çfarë besimi krijohet në ekip.

Ju falënderoj për besimin që më keni dhënë gjatë gjithë këtyre viteve, që të mundohemi me shumë çështje dhe të krenohemi me shumë suksese dhe shpresoj që këtë besim ua kam kthyer gjithashtu me besim dhe punë nga e cila ishim të gjithë të lumtur dhe të kënaqur së bashku.

Shqipëria, Lufta e Ftohtë, Traktati i Varshavës dhe baza ushtarake e Pashalimanit

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Buletin me vlera për studiuesin ushtarak

AQFA në këtë fundviti botoi "Buletini Arkivor Ushtarak" me një përmbledhje të dokumenteve që gjenden për Traktatin e Vrashavës dhe Luftën e Ftohtë në Shqipëri. Botimi i këtij buletini, tashmë të mirëpritur nga studiuesi ushtarak dhe civil, ka sjellë dokumentet që janë pjesë e fondeve të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë herë bordi i botimit me shumë të drejtë ka publikuar dokumente që përfshijnë një periudhë shumë të veçantë të Luftës së Ftohtë, që lidhet me pjesëmarrjen e Shqipërisë në Traktatin e Varshavës prej vitit 1955-1968.

Lexuesi nëpërmjet dokumenteve që botohen për herë të parë, njihet me të dhëna të nxjerra nga Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH) dhe Drejtoria Politike që flasin për Traktatin e Varshavës dhe krijimin e Komandës së Bashkuar të FA-së dhe ndihmës reciproke të shteteve pjesëmarrëse si Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Polonia, Bashkimit Sovjetik (BS), Çekosllovakia dhe Republikës Demokratike Gjermane, si dhe të Traktatit të Miqësisë dhe Bashkëpunimit Reciprok ndërmjet tyre.

Në këtë buletin do të njiheni me Komitetin Qendror të PPSH-së mbi mosmarrëveshjet që kishin lindur midis PK të Bashkimit Sovjetik dhe PK të Kinës, si dhe me mosmarrëveshjet midis Shqipërisë dhe BS për problemin e Bazës Luftarake-Detare të Pashalimanit. Dokumente të tjera paraqesin kursin e afrimit të shtetit shqiptar me Republikën e Kinës.

Buletini pasqyron në mënyrë të

detajuar dokumente lidhur me ashpërsimin dhe qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj veprimtarisë antishqiptare të N. Hrushovit. Dokumente të tjera pasqyrojnë denoncimin e shtetit shqiptar të Traktatit të Miqësisë me këto vende etj.

Dokumentet pasqyrojnë dhe raportin e MMP, si dhe mbledhjen e Këshillit të Mbrojtjes së bashku me vendimet, si dhe masat për rritjen e mëtejshme të gatishmërisë luftarake të Ushtrisë Popullore të Shqipërisë ndaj një agresioni të mundshëm ajror dhe detar nga forcat ushtarake të Traktatit të Varshavës.

Në Bazën Ushtarake të Pashalimanit

Në bazën ushtarake të Pashalimanit nga nëntori i vitit 1960, kishte filluar acarimi i marrëdhënieve të efektivit të përbashkët shqiptar-sovjetik. Ashpërsia e marrëdhënieve dhe ngritja e tensionit kishte filluar në gjysmën e dytë të nëntorit 1960, në ditët e fundit të marsit dhe në fillimet e majit të vitit 1961. Karakteristikë e tyre ishte se qeveria sovjetike kishte organizuar dhe ndërmarrë sulme kundër qeverisë shqiptare dhe udhëheqjes së partisë. Gjatë nëntorit, delegacioni i PPSH-së, që ishte në Konferencën e 81-të të Partive Komuniste dhe Punëtore në Kremlin nga udhëheqja sovjetike i bëhej shantazh.

Efektivit sovjetik të bazës ushtarake të Pashalimanit iu dha sinjali për të ndërmarrë veprime arbitrare në kundërshtim me marrëveshjet për bazën e përbashkët. Muajt dhjetor, janar, shkurt dhe në gjysmën e parë të marsit 1961, në bazën ushtarake të Vlorës u punua normalisht nga efektivit i përbashkët. Planet e stërvitjes luftarake, siç i vërtetojnë dokumentet, u zbatuan në rregull dhe regjimi operativ i bazës u zhvillua me kualitet megjithëse gabime dhe

të meta të zakonshme shfaqeshin nga të dy palët.

Disa ditë para mbledhjes së komitetit politik konsultativ të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, në bazën ushtarake të Pashalimanit si me sinjal filluan të acaroheshin, kur këshilltarët dhe instruktorët sovjetikë shkelën rregullat e shërbimit të radës, ndërprejnë stërvitjen luftarake dhe daljen e anijeve në det. Kishte filluar një fushatë e hapur shpifjesh në masën e efektivit sovjetik kundër qëndrimit politik të qeverisë dhe partisë. Nga kronologjia e ngritjes së tensionit në bazën ushtarake të Pashalimanit nuk mund të mos tregohet qartë se miti i ngritjes së tensionit dhe burimi i tij ishte Moskë. Në gjysmën e dytë të marsit 1961 qeveria sovjetike me qëllim që të fabrikonte akuza për të vënë pjesëtarët e Traktatit të Varshavës përpara një situatë false të gjendjes në bazën ushtarake të Pashalimanit dhe të merrte aprovimin e tyre për prishjen e saj, iu dha udhëzime këshilltarëve dhe instruktorëve sovjetikë që të punonin në bazën për acarimin e marrëdhënieve me efektivin shqiptar.

Nga gjithë historiku i ngjarjeve del e qartë se në marrëdhëniet sovjetoshqiptare, në bazën ushtarake të Pashalimanit, qeveria sovjetike në këtë bazë gjithnjë kishte parë jo një detashment të fuqishëm luftarak të kampit socialist në pellgun e Mesdheut, por një pikëmbështetje për shantazhe dhe presione të padrejta dhe pa baza ndaj qeverisë së Shqipërisë.

Duhej të largoheshin ata, sovjetikët

Me largimin e 8 nëndetëseve në bazën e Katelnikov dhe me insistimin që bëri pala sovjetike për të mbajtur në Shqipëri instruktorë sovjetikë në Flotën Luftarake Detare shqiptare, çështja që ishte për t'u zgjidhur nuk

u zgjidh, për qëndrimin jo të drejtë të palës sovjetike u ngatërrua dhe më shumë.

Po çfarë u arrit me largimin e 8 nëndetëseve në bazën Katelnikov nga pala sovjetike? Së pari, u dobësua mbrojtja e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe fuqia mbrojtëse e kampit socialist në basenin e Mesdheut; së dyti, u inkurajuan dhe më shumë armiqtë e Republikës Popullore të Shqipërisë në planet e tyre agresive kundër vendit tonë; së treti, u bë ajo që kërkonte Niksoni në bisedimet e tij me udhëheqësit sovjetikë, heqja dorë nga ana sovjetike nga baza lundruese detare e Vlorës si kusht paraprak për të filluar bisedimet rreth likuidimit të bazave amerikane dhe rreth problemit të çarmatimit. U bë pra, në këtë mënyrë edhe një lëshim paraprak i imperializmit për hir të bisedimeve me të. Kuptohet që këto "suksese" sovjetike jo vetëm që nuk e forconin pozitën e sistemit socialist në botë, por e dobësonin atë. Sovjetikët arritën deri aty sa çështjen e largimit të instruktorëve sovjetikë nga grupi i nëndetëseve e quajtën "problem të ri" dhe jo hallkën më të vjetër, më të njohur dhe burimin e të gjithë fërkimeve të ndodhura në bazë.

Për bazën luftarake detare të Pashalimanit dhe mos marrëveshjet e ndodhura, ka shumë dokumente dhe materiale. Në të gjitha këto materiale del qarte se instruktorët sovjetikë, u sollën si komandantë, shkelën dispozitat e karakterit të punës, fyen dinjitetin personal të njerëzve dhe krijuan shkaqe për fërkime. Të evitoheshin fërkimet dhe skandalet duhej tamam të largoheshin ata, sovjetikët. Kjo gjë ishte dhe burimi i mosmarrëveshjeve që lindin në bazë.

Këto qëllime jomiqësore të palës sovjetike nuk mund të realizoheshin. Në një dokument theksohet se: "Pala shqiptare, duke ruajtur respektin e thellë për njerëzit sovjetikë nuk do t'i lejojë instruktorët e bazës luftarake detare të Pashalimanit që të sillen siç janë sjellë deri me sot brutalisht me dinjitetin tonë nacional. Në bazë të marrëveshjeve që ju keni hedhur poshtë nuk do t'i lejojmë ata as të sillen si zot të anijeve, as si komandantë, as të sigurojnë shërbime të veçanta roje, as të merren me punë agjitative kundër udhëheqjes së Partisë e të shtetit tonë siç janë marrë deri tani një pjesë e tyre dhe as të lidhen direkt, d.m.th. jo nëpërmjet komandës sonë të Flotës me ndërlydhje me mjete radioteknike me jashtë, gjë që është në kundërshtim me të drejtat tona si shtet sovran. Pala jonë edhe në këto kondita që ju me qëllim ecni në rrugën e acarimit të marrëdhënieve midis vendeve tona,

nuk ka kundërshtim që të mbahet ndërlydhja teknike midis flotave tona, por jo këtë ta bëjnë persona individë të ndodhur në Shqipëri me cilësinë e instruktorit".

Duke insistuar në tërheqjen e menjëhershme të instruktorëve sovjetikë nga Flota luftarake detare shqiptare, qeveria shqiptare paralajmëroi se mbi këto vija pala jonë do të përpiqet për të vënë në binarët e nevojshëm, sipas marrëveshjeve ekzistuese aktivitetin dhe qëndrimin



e mëtejshëm të padëshiruar nga ne të instruktorëve sovjetikë, që ju insistoni të mbani në bazën luftarake detare të Pashalimanit.

Qëndresa e oficerëve dhe marinarëve shqiptarë

Në janar të vitit 1961, kundëradmiral Hito Çako ngriti në këmbë me alarm luftarak brigadën e ruajtjes së rajonit të ujërave në ishullin e Sazanit dhe garnizonin e ishullit, ndërsa kundëradmirali Abdi Mati i shpalli alarm shtabit dhe organeve të drejtimit të flotës në Pashaliman. Mbi ngritjet në alarm luftarak nuk u informuan këshilltarët dhe komandanti i Brigadës së Nëndetëseve.

Po në muajin janar 1961, RLS e tipit "Lot" në ishullin e Sazanit diktoi në kanalën e Otrantos një grup anijesh të panjohura (deri 20 copë). Por këshilltarët në shtabin e flotiljes dhe komanda e brigadës së nëndetëseve nuk u njoftuan. Në shkurt 1961 përsëri u diktua një grup anijesh të panjohura në kanalën e Otrantos. Por edhe në këtë rast këshilltarët dhe brigada e nëndetëseve nuk u vunë në dijeni. Gjithashtu nuk u mor asnjë masë për rritjen e gatishmërisë luftarake të flotës dhe për zbulim. Oficerët e rojës të grupit shqiptar të nëndetëseve nxjerrin në radë me kokën e tyre, pa lejen e oficerit të rojës të brigadës, anije ndihmuese dhe katera. Vazhdimisht bëhej lundrim i katerëve dhe anijeve të flotës në rajonin e Pashalimanit nëpër poligonet e stërvitjes pa pëlqimin e komandantit të brigadës së nëndetëseve.

Kështu, ish komandanti i flotiljes shqiptare, kundëradmiral Abdi Mati,

në fund të vitit 1960 i dha urdhër komandantit të brigadës së nëndetëseve në një formë të ashpër e brutale duke kërkuar që të vihej në punë baza lundruese "Nemçinov" menjëherë dhe pa marrë parasysh motin (në kohë kur frynte erë e fortë, kishte dallgë dhe ishte erërsirë).

Në bazën lundruese "Nemçinov", ku ekuipazhi shqiptar ndodhej me cilësinë e nxënësit, dhe anija ishte nën përgjegjësinë dhe drejtimin e

ekuipezhit dhe komandantit sovjetik, shërbimi shqiptar i dezurnit shkeli rregullat e shërbimit të anijes. Në anije hynin e dilnin dhe shumë oficerë dhe marinarë shqiptarë, gjë për të cilën komandanti sovjetik nuk vihej në dijeni.

Komandanti i ekuipazhit shqiptar të bazës lundruese "Nemçinov", Kapiteni i Rangut të 2-të Stavri Çika dhe ndihmësi i tij Kapiteni i Rangut të 3-të Jani Bushi, me kokë të tyre japin udhëzime për vendosjen e oficerëve në kabina pa rënë dakord me komandantin sovjetik, ndërsa disa oficerë shqiptarë okupuan arbitrarisht kabinat. Kështu kanë vepruar dhe Kapiteni i Rangut të 3-të Dashmir Ohri, komandanti i nëndetëses S-270 Toger Aleko Pojani, Kapiteni i Rangut të 11-të Shezai Kasaj, Kapiteni i 1-rë Muharrem Molla, komandant Toger Petrit Pojani, etj.

Duke qenë se arkivi mbart kujtimet e një periudhe të caktuar historike të vendit, krijon dhe një mundësi për të komunikuar pozitivisht me studiuesit dhe me publikun, duke nxjerrë në pah cilësitë morale dhe njerëzore, disiplinën dhe përgatitjen, ndjenjën e fortë që ka karakterizuar pasionin për të bërë një forcë të armatosur për të ecur përpara. Sfidat që qëndrojnë sot për arkivin kërkojnë nxitjen e këtij procesi, përdorimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, duke e kthyer në një qendër dhe burim të njohurive dhe të krijimit të FA-së. Ky rrugëtim i Buletinit Arkivo-Ushtarak tashmë është i përcaktuar qartë dhe FA-të krenohen me një institucion të tillë.



FAN NOLI - Dishepujve iu festohen veç ditëlindje

U lind më 6 janar 1882, me emrin Theofanes Stylianos Mavromatis, në fshatin shqipfolës Ibriktepe, në Trakinë Lindore, asokohe vilajeti i Edrenesë. Si disa fshatra të tjerë të asaj krahine të banuar me shqiptarë, qyteza kishte ruajtur me kohë gjuhën, doket dhe traditat e të parëve. Noli e kon-

sideronte fisin e vet me prejardhje nga qyteza e Kolonjës. I ati, Stilian Gjergj Noli, ishte psalt në kishën ortodokse të fshatit; e ëma, Marie Gollaqi, ishte shtëpiake. Theofani ishte i dyti ndër trembëdhjetë fëmijë, shtatë prej të cilëve vdiqën në foshnjëri. Familja rronte me tokat që kishte në pronësi. Sa që i mitur, Noli hoqi sëmundje të rënda, prandaj shkollën e nisi me vonesë.

Nga i ati trashëgoi dashurinë për muzikën kishtarë si dhe për adhurimin e heronjve, veçanërisht kultin e Napoleonit. Në fshatin e lindjes kreu shkollimin fillor greqisht për gjashtë vite, më tej prindërit e dërguan në gjimnazin grek të Edrenesë, ku qëndroi katër vite.

Në vitin 1900 vendosi të shkonte në Greqi, por gjatë qëndrimit në Stamboll u sëmur, qëndroi atje për

t'u kuruar e pastaj punoi për ca kohë në një ëmbëltore. Vitin tjetër u nis për në Athinë dhe të njohurit e tij i gjetën vend si nëpunës në një shoqëri belge, e cila kishte koncesionin e tramvajeve me kuaj në qytet. U regjistrua në Fakultetin e Filozofisë në kryeqytetin grek. Më tej, meqë kishte prirje për aktor, punoi si kopist, sufler e aktor me një trupë teatri me të cilën u end nëpër Greqi për gati dy vjet. Gjatë endjeve me trupën shkroi dramën "To ksipnima" ("Zgjimi"), e cila u luajt nga trupa në Pirgos të Peloponezit. Atë periudhë nisi të shkruante skeletin e dramës "Israelitë dhe filistinë". Në fillim të 1903 shkoi në Egjipt, ku gjeti punë si mësues lëvizës greqishteje dhe po atë vit përktheu në greqisht traktatin e Sami Frashërit "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet". Po atje filloi të bjerë në kontakt me veprimtarët e Rilindjes Kombëtare në koloninë shqiptare të Egjiptit, ndër të cilët Thanas Tashko dhe Jani Vruho e ndihmuan të botohej përkthimi; gjithashtu e lidhën me Spiro Dinen, Nikolla Naçon, Shahin Kolonjën e Kristo Luarasin. Qëndroi në Shibin el Kom dhe El Faiyum, ku përpos mësimit të greqishtes qe edhe këngëtar i koreve kishtarë. Me Tashkon dhe Vruhon gatiti botimin e së përkohshmes "Shkopi", që botohej në Kairo.

Pas tre vjetësh qëndrimi në Egjipt, në prill 1906 u nis për në Shtetet e Bashkuara, duke kaluar nga Napoli, dhe mbërriti në Nju Jork më 10 maj. Pasi ndenji në Buffalo, ku punoi në një fabrikë të sharrës për tre muaj, Noli shkoi në Boston. Në gushtin e po atij viti gjeti punë në Filadelfia, por e la pasi Sotir Peci i ofroi të bëhej zëvendës redaktor i së përkohshmes "Kombi".

Me zgjedhjet e mbajtura, më 5 prill 1921, zgjidhet deputet i Kolonisë së Amerikës në legjislaturën e dytë (21 prill 1921 - 30 shtator 1923). Ai shërbeu si ministër i Jashtëm në qeverinë e Xhaferr Ypit, vetëm për pak kohë përpara se të dorëhiqej. Noli ishte kryetar i Partisë Popullore, e majta e asaj

kohe, kundrejt Partisë Përparimtare. Përkrah Luigj Gurakuqit dhe Stavro Vinjaut është ndër oratorët më shpotitës të foltores parlamentare. Më 21 nëntor 1923, u shugurua peshkop i Korçës dhe mitropolit i Durrësit në Durrës, ndërsa më 27 dhjetor 1923 u zgjodh deputet i Korçës.

Gjatë Lëvizjes së qershorit 1924 Noli nuk ishte për përmbysjen me forcë që ndodhi; ai u vendos në krye të saj vetëm si kërkesë e krahut të të rinjve, që shihnin tek ai një njeri me formim perëndimor e amerikan. Qeveria e ligjshme e rikthyer me "Fitoren e Legalitetit", më 24 dhjetor, e dënoi Nolin me vdekje në mungesë. Programi i tij me njëzet pika për modernizimin



dhe demokratizimin e Shqipërisë, ndër të cilat edhe reforma agrare, ishte tejet i nxituar e idealist për një vend të prapambetur dhe pa tradita parlamentare. Më vonë Noli i shkroi arsyet e dështimit të tij në një letër që ia drejtonte një mikut të tij anglez "Duke këmbëngulur tek reformat agrare, zgjova zemërimin e aristokracisë çifligare; duke mos i zbatuar reformat, humba mbështetjen e masave fshatare". Ardha e një delegacioni sovjetik me në krye Arkady Krakovetsky shqetësoi kancelaritë perëndimore

deri në atë pikë, sa të mbështesnin ardhjen e Zogut me anë të 106-112 oficerëve të ish-Ushtrisë Perandorake Ruse.

Sipas Këlcyrës në memuaristikën e tij, vërente se lidhjet me Bashkimin Sovjetik ishin munduar ngaherë t'i sendërtonin, por ishte pikërisht kjo lëvizje që duhej të soste. Vepra e parë e Nolit qe drama me tre-akte "Israelitë dhe Filistinë", e botuar në Boston 1907. Kjo dramë qe shkruar qysh më 1902, bazuar në historinë e Samsonit dhe Dalilës në Dhjatën e Vjetër. Duke ndërre nevojën e besimtarëve për të mbajtur meshë në shqip, përkthen ritualet dhe liturgjinë ortodokse në dy vëllime "Librë e shërbesave të shënta të kishës ortodokse", Boston 1909, dhe "Libre é te krémtevé të mëdha të kishës ortodokse", Boston 1911. Përkthime që ai i çmonte si arritjet më të mëdha të tij. Më 1921 doli vepra e tij madhështore në prozë "Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit), mbretit të Shqipërisë 1412-1468", Boston. Në Shqipëri erdhi sërish në fillim të viteve '20. Më 1947 botoi përpunimin që i bëri "George Castrioti Scanderbeg" (1405-1468), New York 1947; që do i shërbente si temë diplome në Universitetin e Bostonit. Tjetër vepër e tij në anglisht "Bethoveni dhe Revolucioni francez" (Beethoven and the French revolution) në 117 faqe, e botuar në New York 1947, pasqyronte figurat e mëdha të historisë (Jul Çezari, Jezusi, Skënderbeu dhe Napoleon Bonaparte). Vëllimi me vjersha "Albumi" u botua më 1948. Brenda viteve 1961-1963 botoi dy vjershat e fundit origjinale dhe disa shqipërime vjershash të poetëve të njohur. Kontributi më i gjerë i Nolit qe në fakt ai i stilistit, siç shihet në përkthimet e tij. Bashkë me Faik Konicën mund të vlerësohet si ndër stilistët më të mëdhenj të dialektit Toskë. Afria që kishte me gjuhët e huaja, greqishten, anglishten dhe frëngjishten e aftësoi ta bënte shqipen në një gjuhë të stërholluar dhe elegante, ndonëse folklorike.



Q K M B M M F A u r o n
Gëzuar Vitin e Ri 2022!

